

MBRETËRIT E SPORTIT 2018



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministry of Culture, Youth and Sport


iutecredit
MË TË SHPEJTIT DHE MË TË THJESHTIT


Hotel SIRIUS
Conference Center
 **TOYOTA**



KOSOVAPRESS

KOSOVO



Olimpi - Revistë tre-muajshe

Përgatiti: **Kushtrim Krasniqi**

Fotot: **Shpend Ahmeti**

Fotot tjera: IJF, FFK, FBK, FKK, FHK, Facebook

Botimi:

Komiteti Olimpik i Kosovës/Kosovo Olympic Committee

Adresa: Rruga Agim Ramadani,

Nr. 253, Kati i Parë, 10 000 Prishtinë

www.noc-kosovo.org

Rrjetet sociale:

<https://www.facebook.com/kosovollympiccommittee/>

<https://www.instagram.com/kosovollympiccommittee/>

<https://twitter.com/NOCKOSOVO>

https://www.youtube.com/channel/UCdU002ZSh8bs_mnGzv8fdKg

Dizajni: **Berat Ymeri**

Shtypi: **Shtypshkronja Blendi**



PËRMBAJTJA

10

Nora e Akili të nderuar që u bënë pjesë e historisë

14

Kategorizimi 2019

18

Vrella e Kokaj përfaqësuan Kosovën në EYOF Sarajeva 2019

20

KOK ndanë edhe 41 mijë € për 18 bursistët Olimpikë Tokio 2020

29

Profesoresha e MEMOS, Tracy Taylor, ligjëroi në modulën 6 të kursit ASMC 1

31

Kosova drejt Minsk 2019

44

Kosovës i mungoi fati, i nisi me barazim kualifikimet për EURO 2020

55

KOK dërgon trajnerët e federatave në kampe jashtë vendit

56

Ngritja e hendbollit

KALENDARI I LOJËRAVE 2019



**LOJËRAT
EVROPIANE
MINSK 2019
21 - 30 qershor**



**FESTIVALI
OLIMPIK
EVROPIAN PËR
TË RINJ BAKU
2019
21 – 27 korrik**



**LOJËRAT
MESDHETARE
NË RËRË
PATRAS 2019
25 - 31 gusht**



**LOJËRAT
BOTËRORE
NË RËRË SAN
DIEGO 2019
10-15 tetor**

Olimpi

Synimi për të vazhduar rrugën e të qenit në top-10 Komitetet Olimpikë më të mira në botë, premtim ky i dhënë presidentit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe mikut tonë, Thomas Bach, po vazhdon me projektin e ri, të emërtuar “Olimpi”.

Pas librit foto-reportazh “Debutimi i Artë”, kushtuar medaljes së artë Olimpikë të krenarisë mbarëshqiptare, Majlinda Kelmendi, Olimpi do të jetë revistë tre muajshe, e cila do të botohet e tëra ‘kolor’.

Olimpi 60-faqësh do të pasqyrojë aktivitetet e Komitetit Olimpik të Kosovës, ngjarjet ndërkombëtare të sportistëve tanë, me theks të veçantë ngritjet në podium, por që nuk do të mungojnë edhe intervistat dhe rubrikat e ndryshme.



Olimpi do të jetë dritare e re e promovimit të sportistëve dhe sportit të Kosovës...

Numri i parë i kësaj reviste vjen në kohën më të mirë, në tre muajshin tejet të suksesshëm të sportit tonë, ku numri i medaljeve ndërkombëtare shkoj në 26, 21 vetëm nga sporti tashmë tejet i famshëm në vendin tonë, xhudo, me arkitektin e gjithë këtyre sukseseve, Driton Kuka. Nuk munguan edhe medaljet evropiane të fituara nga karateja, si dhe ato ballkanike nga mbretëresha atletikë, që japin shpresë për të ardhmen.

Në tre muajt e parë të 2019-ës, sportet ekipore vazhduan të rikthejnë shikueshmërinë, ku gjetja e një bilete në futboll dhe basketboll duket më e vështirë se sa marrja e vizës! Edhe në hendboll e volejboll, ngritja po vazhdon.

Tre muajshi i parë na zë edhe me ceremoninë e Laureatëve 2018, në të cilën u sublejuan sukseset e gjithë sportistëve në vitin 2018. Për herë të parë në histori, vëlla e motër u bënë mbretërit e sportit.

Deri në numrin e dytë, ku në tre muajshin e ardhshëm KOK-un e pret ngjarja më e rëndësishme këtë vit, Lojërat Evropiane Minsk 2019, në të cilat synimet për medalje janë të mëdha, lexim të këndshëm të Olimpiti.

Besim Hasani

President i Komitetit Olimpik të Kosovës

Olympus

Continuing to be in the top-10 best Olympic Committees in the world as a promise given to the president of the International Olympic Committee and to our friend, Thomas Bach, is progressing through the new project named “Olimpi” (the Olympus).

After the reportage book “Debutimi i Arte” (The Golden Debut), dedicated to the Golden Medal of the Albanian pride, Majlinda Kelmendi, the magazine “Olimpi” is going to be a three-month magazine published in colours.

“Olimpi” will have 60 pages that are going to reflect the activities of the Kosovo Olympic Committee, the international events of our athletes with special emphasis on the podium, but will not miss the different interviews and various sections either.

“Olimpi” will be the window of promoting Kosovo athletes and sports...

The first issue of this magazine comes at its best time, in the very successful three months of our sport where the number of international medals went to 26. 21 medals were won only from the already famous sport in our country, judo, together with the architect of all these successes, Driton Kuka. There were also European medals won in karate, as well as the Balkan ones in athletics which have created hope for a successful future.

In the first three months of 2019, team sports continued to return their visibility, where finding a football and basketball ticket seems to be harder than getting a visa! Even in handball and volleyball, the raise is continuing.

The first three months belong also to the Laureate 2018 ceremony, which featured the success of all athletes in 2018. For the first time in history, the siblings became the kings of the sport. Until the second issue of the magazine, which will also cover the participation of NOC in the most important event of the year, the European Minsk 2019, have a pleasant time reading “Olimpi”.



LAUREAT

ГЕТ 2018



Nora e Akil Gjakova, mbretërit e sportit 2018 në Kosovë

1 mars 2019 - Xhudistët, Nora e Akil Gjakova janë mbretërit e sportit në Kosovë për vitin 2018. Motër e vëlla, fituan çmimet kryesore në ceremoninë e zgjedhjes së Laureatëve 2018, të organizuar mbrëmë për herë të tretë nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Ceremonia e mbajtur në Restaurant Golden Imperial në Prishtinë, mbledhi figurat më të shquara të sportit, politikës dhe kulturës, derisa veçohet ministri për Kulturë, Rini e Sport, Kujtim Gashi, kampionia Olimpik Majlinda Kelmendi, e cila ia ndau çmimin trajnerit të saj, Driton Kuka, presidenti i Komitetit Olimpik të Shqipërisë, Viron Bezhani, aktorët e mirënjohur, Rasim Thaqi (Cima), Leze Qena, Besim Dina, ambasadorë të ambasadave të huaja në Prishtinë etj.

Kampionia e Evropës për vitin e kaluar dhe e Lojërave Mesdhetare Tarragona 2018, Nora Gjakova, fitoi çmimin "Sportistja e Vitit 2018". Ndërsa, Akil Gjakova, që gjatë vitit 2018 fitoi medaljen e artë në Grand Slamin e Parisit, u bë kampion i Evropës për U-23, si dhe medalist i artë në Lojërat Mesdhetare Tarragona 2018, fitoi çmimin "Sportisti i Vitit 2018", i cili iu nda nga sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, nënpresidenti Gazmend Maxhuni, si dhe presidenti i KOK-shit, Viron Bezhani.

Het-trik i Driton Kukës

Trajneri i tyre, Driton Kuka, fitoi për herë të tretë epitelin e "Trajnerit të Vitit", por këtë herë çmimin ia ndau nxënësja e tij, Majlinda Kelmendi.

Xhudoja mori edhe dy çmime tjera. Shpat Zeka u vlerësua si "Shpresa më e mirë Olimpik", pas bërjes nënkampion i Evropës për junior, ndërsa Erza Muminoviqit, ndërsa i njëjti çmim por në konkurrencën e femrave i takoi Erza Muminoviqit, medaliste e bronzit nga Lojërat Olimpikë për të Rinj "Buenos Aires 2018" dhe kampione e Evropës për kadete.

Kombëtarja e futbollit u shpall më e mira, pas suksesit të vitit të kaluar, ku nuk pësoi asnjë humbje në nëntë ndeshjet e zhvilluara. Çmimin e pranoi përzgjedhësi Bernard Challandes.

Me "Çmimin Special" u nderua Kombëtarja e karatesë në konkurrencën e femrave, të cilat zunë vendin e shtatë në botë dhe të dytin në Ballkan.

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, në fjalën e tij, përmendi promovimin e madh që po ia bënë sporti dhe sportistët shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ai përmendi edhe sakrificat e mëdha të sportistëve për të ardhur deri tek medalja Olimpikë, si dhe

numrin prej 106 shteteve që ndoshta ende nuk e njohin ndjenjën e medaljes së artë Olimpikë.

Ministri Kujtim Gashi foli për mbështetjen e vazhdueshme të MKRS-s për sportin, derisa e cilësoi si ndër më të mirin vitin që lam pas.

Shpërblimi 500-2000€

Për të gjithë të shpërblyerit u ndanë edhe shpërblimet prej 500-2000 Euro, si dhe Çmimi "Vrapuesja Ilire".

Ceremonia u përshkrua me video-materiale të ndryshme, pika artistike-muzikore, derisa mbrëmja u transmetua drejtpërdrejt në RTK dhe Kosova Press, kurse sponsor i Laureatëve 2018 ishte Qumështorja Drena.

Risi ishte edhe momenti i nënshkrimit të të gjitha laureatëve në tri vitet e fundit, ku fotot e tyre qëndronin në një pllaketë të veçantë.

The Siblings, Nora and Akil Gjakova, won the main prizes at 2018 Laureate Ceremony

The Judoists, Nora and Akil Gjakova are the conquerors of sport in Kosovo for 2018. The siblings won the main prizes in the 2018 Laureate Announcement Ceremony organized last night for the third time by the Kosovo Olympic Committee.

The last year's European champion and that of the Mediterranean Games Tarragona 2018, Nora Gjakova, won "Female Athlete of The Year" prize in 2018. "It is a great honor for me to become amongst the best athletes of Kosovo," said Nora.

Whereas, Akil Gjakova who won the gold medal at 2018 Grand Slam in Paris, who became Europe's Champion of U-23 and also Gold Medallist at the Mediterranean Games Tarragona 2018, won "Male Athlete of the Year" prize in 2018.

Their coach, Driton Kuka, won for the third time the epithet of "Coach of the Year", but this time the award was shared by his student, Majlinda Kelmendi.

Judo received two more awards. Shpat Zeka was appreciated as "The Greatest Olympic Hope" after becoming Europe's vice-champion for juniors. While the same award but in women's competition was given to Erza Muminovic, the bronze medallist from the Youth Olympic Games "Buenos Aires 2018" and European champion for cadets. Both stressed that the award motivates them for further successes.

The national football team was declared as the best one after the success of last year when no losses were caused. The award was received by the coach Bernard Challandes.

"Special Prize" was awarded to the Karate national team in women's competition, who took the seventh place in the world and the second in Balkan.

The President of the Kosovo Olympic Committee, Besim Hasani, in his speech, cited the great promotion that sport and sportsmen are doing to the country of Kosovo in the international arena.

Minister Kujtim Gashi spoke about the continuous support of the Ministry of Culture, Youth and Sport, while he considered last year as the most successful one.

For all the prize-winners, the prizes of 500-2000 Euros were awarded, as well as the "Illyrian Racer" prize.





Akil Gjakova (i dyti nga e djathta), "Sportist i Vitit 2018"



Erza Muminoviq (mes), Shpresa e Vitit 2018



Bernard Challandes (djathtas), përzgjedhës i Kombëtares së Futbollit



Shpat Zekaj (djathtas), Shpresa e Vitit 2018



Akil Gjakova, Nora Gjakova e Distria Krasniqi, duke pozuar para sponsorit të ceremonisë Laureatët 2018, Drena



Majlinda Kelmendi duke ia ndarë çmimin Driton Kukës



Karateja (f), "Çmimi Special 2018"

Nora e Akili të nderuar që u bënë pjesë e historisë

“Është nder për mua të bëhem pjesë e historisë së sportistëve më të mirë të Kosovës”, deklaroi Nora Gjakova.

Sportistja më e mirë e vitit 2018, Nora Gjakova, u shpreh e nderuar që fitoi çmimin e sportistes më të mirë të vitit 2018.


Në fjalimin e saj, ajo falënderoi Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport,

të cilat po punojnë në avancimin e sportistëve drejt sukseseve.

“Faleminderit Komitetit Olimpik të Kosovës. Më vjen mirë që ky çmim u nda nga presidenti Besim Hasani, që si Komitet kanë punuar drejt avancimit të sportit, si dhe faleminderit ministrit Kujtim Gashi, që ka punuar shumë dhe ka qenë motiv i madh që sukseset tona të vijnë në momentin e duhur, kur jemi drejt kualifikimit Olimpik.

Është nder për mua të bëhem pjesë e historisë së sportistëve më të mirë të Kosovës”, u shpreh Gjakova.

Xhudistja jonë gjatë vitit 2018 u bë kampione e Evropës, pas medaljes së artë të fituar në Tel Aviv të Izraelit. Gjatë vitit të njëjtë, ajo fitoi të artën edhe në Lojërat Mesdhetare Tarragona 2018, si dhe në shumë gara tjera ndërkombëtare.



I nderuar me çmimin “Sportist i vitit”, u shpreh edhe Akil Gjakova. “Falënderoj KOK-un për çmimin, familjen, trajnerin Driton Kuka, dhe

në veçanti kryetarin e Federatës së Xhudos, Agron Kuka”, tha Akili, që gjatë vitit 2018 fitoi medaljen e artë në Grand Slamin e Parisit,

u bë kampion i Evropës për U-23, si dhe medalist i artë në Lojërat Mesdhetare Tarragona 2018,

LAUREATËT 2018

Sportisti i Vitit 2018
Akil Gjakova
Shpërblimi: 2.000 €

Trajneri i Vitit 2018
Driton Kuka
Shpërblimi: 1.000 €

Sportistja e Vitit 2017
Nora Gjakova
Shpërblimi: 2.000 €

Çmimi special
Kombëtarja e karatesë (f)
Shpërblimi: 1000 €

Kombëtarja e Vitit 2018
Futbolli (M)
Shpërblimi: 1500 €

Shpresa Olimpike 2018
Shpat Zeka
Shpërblimi: 500 €

Shpresa Olimpike 2018
Erza Muminoviq
Shpërblimi: 500 €

HISTORIA E LAUREATËVE

LAUREATËT 2016

SPORTISTJA E VITIT
MAJLINDA KELMENDI, xhudiste

SPORTISTI I VITIT
HEROLIND NISHEVCI, karateist

TRAJNERI I VITIT
DRITON KUKA, trajner i xhudos

KOMBËTARJA E VITIT (M)
Hendbolli, seniorët

KOMBËTARJA E VITIT (F)
Volejboli, U-18

SHPRESA E VITIT (M)
Orges Arifi, karateist

SHPRESA E VITIT (F)
DISTRIA KRASNIQI, xhudiste dhe
DONJETA SADIKU, boksierë

ÇMIMI SPECIAL
FADIL VOKRRI, kryetar i FFK-së
SHQIPE ZOGLANI, trajnere e
karatesë

LAUREATËT 2017

SPORTISTJA E VITIT
MAJLINDA KELMENDI, xhudiste

SPORTISTI I VITIT
HEROLIND NISHEVCI, karateist

TRAJNERI I VITIT
DRITON KUKA, trajner i xhudos

KOMBËTARJA E VITIT (M)
Basketbolli, seniorët

KOMBËTARJA E VITIT (F)
Hendbolli, seniorët

SHPRESA E VITIT (M)
Shpat Zeka, xhudist

SHPRESA E VITIT (F)
LAURA FAZLIU, xhudiste dhe
DONJETA SADIKU, boksierë

ÇMIMI SPECIAL:
NORA GJAKOVA, xhudiste



Majlinda Kelmendi dhe Herolind Nishevci, sportistët e vitit 2016



Fituesit e çmimeve në ceremoninë Laureatët 2017



Disa prej laureatëve në vitet 2016 dhe 2017. Në vend të legjendës së ndjerë, Fadil Vokrri, në skenë doli djali i tij, Gramozi



Besim Hasani, president i KOK-ut

“Arsyeja e tubimit të sotëm janë sportistët që vetëm gjatë vitit të kaluar bënë që flamuri i Kosovës të ngritet lartë për më shumë se 50 herë në shumë shtete anekënd botës, madje edhe në shtetet që për arsye palidhje të Qeverive të tyre nuk e njohin shtetin e Kosovës, por janë qytetarët e tyre që me nder e respekt qëndrojnë përballë flamurit të Kosovës!”



Kujtim Gashi, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

“Është vërtetë kënaqësi që jam sonte këtu. Ishin rezultatet që vërtet na bënë të ndjehemi mirë edhe ne si MKRS dhe si Qeveri. Rreth 100 medalje në të gjitha sportet i erdhën vendit tonë në 2018-tën”



Driton Kuka, “Trajneri i Vitit 2018”

“Jam i privilegjuar që mora çmimin nga nxënësja Majlinda Kelmendi. Në vitin 2018 përveç vajzave doli në skenë edhe një djalë (Akil Gjakova), i cili fitoi Grand Slamin e Parisit. Kemi filluar me Lojërat Evropiane 2015, Medaljen Olimpikë 2016, pastaj Lojërat Mesdhetare 2018, ku fituam tri të arta dhe një të argjendtë, si dhe medaljen Olimpikë për të rinj të Erzës. Nuk e di a ka mbetur diçka tjetër pa u fituar. Xhudo tashmë është bërë brend për shtetin e Kosovës”



Adelina Rama, “Çmimi i veçantë 2018”

“Kemi pasur shumë vështirësi, kemi shënuar tri fitore ndaj kombëtareve të mëdha dhe në fund ia kemi dalë bashkarisht të zëmë vendin e shtatë në kampionatin botëror”, tha karateistja, Adelina Rama.



Bernard Challandes, trajner i Kombëtares së futbollit

“Jam i nderuar të jem këtu para jush. Mendoj se e merituam këtë çmim jo vetëm për rezultatet, sepse ne jemi këtu në Lëvizjen Olimpikë për të shprehur edhe vlerat Olimpikë. Ky ekip ka luajtur lojë të bukur, por jo vetëm, pati agresivitet në suaza të fair-playt, pati disiplinë dhe kreativitet, nganjëherë hasëm në vështirësi por gjithmonë ishim krenar”,

HOTEL SIRIUS

www.hotelsirius.net



[siriushotels](#)

Kategorizimi 2019

Rezultatet e dala nga kategorizimi i sporteve, sportistëve dhe trajnerëve për vitin 2019, gjashtë federata në kategorinë A

25 shkurt - Komiteti Olimpik i Kosovës ka publikuar rezultatet e dala nga kategorizimi i sporteve, sportistëve dhe trajnerëve për vitin 2019, bazuar në Rregulloren Nr. 04/2018 për Kategorizimin e Sporteve dhe Rregulloren Nr.05/2018 për Kategorizimin e Sportistëve dhe Trajnerëve, të nxjerra nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport.

Pas dy javësh shqyrtimi të dokumentacioneve të të gjitha federatave, komisioni për kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve, ka kategorizuar 29 federata, ndërsa dy të tjera mbetën jashtë kategorizimit.

Presidenti i KOK-ut, Besim Hasani, vlerësoi lartë punën profesionale të komisionit, derisa shtoi se kategorizimi po bëhet sipas standardeve të larta dhe një veprim i tillë Kosovën e rendit tek vendet e avancuara përse i takon financimit të sporteve, sportistëve dhe trajnerëve. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, njëherit kryetar i komisionit për kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve, theksoi se gjatë vitit të kaluar është bërë plotësim ndryshimi i rregullores dhe rregullorja e re, e cila është më e lehtë dhe më e qartë në vlerësimin e kriterëve.

Ai shtoi se, badmintoni nuk u kategorizua shkak të themelimit të vonshëm dhe mos licencimit nga MKRS, ndërsa minigolfi për shkak të numrit të vogël të sportistëve dhe mos zhvillimit të garave gjatë vitit 2018.

I pranishëm në konferencë ishte edhe nënpresidenti, Gazmend Maxhuni, njëherit anëtar i komisionit.

Në bazë të rezultateve, në kategorinë A ndodhen: Xhudo, karate, futboll, basketbolli, hendbolli dhe volejboli, ndërsa në kategorinë B janë: atletika, noti, sporti shkollorë, skitaria dhe pingpongu.

14 federata përbëjnë kategorinë C si: tenisi, mundja, boksi, taekwondo, gjimnastika, shahu, shenjëtaria sportive, shigjetaria, bodybuildingu, çiklizmi, peshëngritja, boulingu, aeronautika dhe autosportet. Në kategorinë e fundit, D janë: Sporti Universitar, kickboxi, bjeshtkataria dhe Federata Sportive e Punëtorëve.

Në kategorizimin e sportistëve kanë hyrë 15 sportistë, prej tyre tetë nga xhudoja dhe pesë nga karate, derisa prinë kampionia Olimpikë Majlinda Kelmendi me 100 pikë. Trajneri i xhudos, Driton Kuka i prinë listës së trajnerëve me 177.50 pikë, i pasuar nga Shqipe Zogiani (karate) me 55 pikë.

KATEGORIZIMI I SPORTEVE 2019

Emri i Federatës

KATEGORIA A	2019 (pikët)
Federata e Xhudos e Kosovës	86.2 pikë
Federata e Karatesë e Kosovës	86
Federata e Futbollit të Kosovës	81.35
Federata e Basketbollit të Kosovës	73.08
Federata e Hendbollit të Kosovës	72.28
Federata e Volejbollit të Kosovës	71.67

KATEGORIA B

Federata e Atletikës të Kosovës	63.416
Federata e Notit të Kosovës	54.086
Federata e Sportit Shkollorë të Kosovës	54
Federata e Skitarisë të Kosovës	53.64
Federata e PingPongut të Kosovës	51.76

KATEGORIA C

Federata e Tenisit të Kosovës	49.57
Federata e Mundjes të Kosovës	47.89
Federata e Boksit të Kosovës	46.43
Federata e Taekwondosë të Kosovës	44.26
Federata e Gjimnastikës së Kosovës	43.69
Federata e Shahut të Kosovës	41.65
Federata e Shenjëtariisë Sportive	40.93
Federata e Shigjetariisë së Kosovës	40.865
Federata e Bodybuildingut	38.91
Federata e Çiklizmit të Kosovës	38.2
Federata e Peshëngritjes të Kosovës	36.37
Federata e Boulingut të Kosovës	35.04
Federata e Autosporteve të Kosovës	31.51
Federata e Aeronautikës të Kosovës	30.94

KATEGORIA D

Federata e Sporteve Universitare të Kosovës	28.57
Federata e Kickboxit të Kosovës	27.21
Federata e Bjeshtkatarisë së Kosovës	24.61
Federata e Punëtorëve Sportiv të Kosovës	20.88

Federata e Badmintonit të Kosovës	Nuk është kategorizuar
Federata e Minigolfit të Kosovës	Nuk është kategorizuar

KATEGORIZIMI I SPORTISTËVE

Xhudo

Majlinda Kelmendi (xhudo)	100 pikë
Nora Gjakova (xhudo)	60
Distria Krasniqi (xhudo)	50
Loriana Kuka (xhudo)	45
Akil Gjakova (xhudo)	45
Shpat Zeka (xhudo)	25
Erza Muminoviq (xhudo)	20
Laura Fazliu (xhudo)	10

Karate

Herolind Nishevci	60
Adelina Rama	20
Fortesa Orana	20
Orges Arifi	15
Blodin Pakashtica	15

Kategorizimi i trajnerëve

Driton Kuka	177.5 pikë
Shqipe Zogiani	55
Nazmi Gashi	10
Zijadin Kryeziu	7.5
Besim Brahimi	6.25

Atletikë

Musa Hajdari	15
--------------	----

Boks

Donjeta Sadiku	12.15
----------------	-------



Pamje nga konferenca për shtyp e drejtuesve të KOK-ut, presidentit Besim Hasani (në mes), sekretarit të përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj (majtas) dhe nënpresidentit Gazmend Maxhuni

©Komiteti Olimpik i Kosovës



KATEGORIZIMI I SPORTEVE 2019	
KATEGORIA A (70-100 pikë)	
Federata e Xhudos e Kosovës	86.20 pikë
Federata e Karatesë e Kosovës	86.00
Federata e Futbollit e Kosovës	81.35
Federata e Basketbollit e Kosovës	72.58
Federata e Hendbollit e Kosovës	72.28
Federata e Volejbollit e Kosovës	71.87

KOSOVO





Ekipi Olimpik i Kosovës në EYOF Sarajeva 2019

10 shkurt - Ekipi Olimpik i Kosovës ka parakaluar në ceremoninë hapëse të Festivalit Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) "Sarajeva dhe Sarajeva Lindore 2019".

Ceremonia hapëse u mbajt të dielën mbrëma në stadiumin Olimpik "Asim Ferhatović Hasa" të Sarajevës, në të cilin 35 vjet më parë u hapën Lojërat Olimpike Dimërore "Sarajeva 1984".

Flamurin e Kosovës e barti skitarja 16-vjeçare, Klea Vrella. Krahas Vrellës, Ekipi Olimpik i Kosovës gjatë parakalimit përbëhej edhe nga: Elba Kokaj (skitare), Feim Kollçaku (trajner), Egzon Agani (trajner), Jeton Rudari (shef i misionit) dhe Kushtrim Krasniqi (zyrtar për media). Vendi ynë po përfaqësohet në EYOF me të dy skitaret, Klea Vrella dhe Elba Kokaj.

Hapjen zyrtare të EYOF-it, para rreth 20 mijë tifozëve dhe 1600 sportistëve nga 46 shtete të Evropës, e bënë presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës, Janez Kocijančiq, si dhe drejtuesit e shtetit boshnjak dhe qytetit të Sarajevës.

Më pas ceremonia u përshkrua me koreografi madhështore, të përcjellura me fishekzjare.

Vrella e Kokaj përfaqësuan Kosovën në

Skitaret tona, Klea Vrella dhe Elba Kokaj, përfaqësuan Kosovën në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF), Sarajeva dhe Sarajeva Lindore 2019. Ato garuan në sllallom dhe sllallom të madh.

13 shkurt – Klea Vrella e Elba Kokaj garuan në sllallom dhe sllallom të madh në EYOF Sarajeva 2019. Klea në sllallom të madh zuri vendin 71, me kohë 3:22.27 sekonda nga të dy lëshimet (1:39.50 sek. dhe 1:44.47 sek.) ndërsa Elba të 72-tin me kohë 3:24.77 sekonda nga të dy lëshimet (1:40.87 sek. dhe 1:43.90 sek.).

Në total pjesëmarrëse ishin 101 garuese, kurse 29 dolën nga shtegu ose u diskualifikuan.

Dy ditë më parë (11 shkurt), garueset tona nuk arritën të përfundojnë garën në disiplinën e sllallomit.

Trajneri Feim Kollçaku u shpreh i kënaqur me paraqitjen e skitareve, marrë parasysh kushtet e vështira që mbretërojnë në Kosovë për këtë sport.

“Duke u nisur nga vetë gara, cilësia, kushtet dhe vetë konkurrenca e madhe e garueseve, ku ishin 46 shtete, vajzat i kanë përmbushur kërkesat tona, duke e përballuar këtë shtegë të njohur të sllallomit të madh Olimpik përplotë me akull. Për këtë i përgëzoj të dy skitaret, të cilat arritën ta përfundojnë garën me një sukses solid. Falënderoj edhe trajnerin, Egzon Agani, për kontributin dhe bashkëpunimin e sinqertë qëkëishim gjatë këtyre ditëve”, tha Kollçaku.

Skitaret u shprehën të kënaqura me atë që treguan në sllallom të madh. “Jam e kënaqur me rezultatin, marrë parasysh kushtet të cilat i kemi në Kosovë. Konkurrenca ishte shumë e fortë. Mendoj se garimi në EYOF është një përvojë e mirë për ne”, deklaroi Vrella.

“Sot jam paraqitur më mirë se sa në sllallom. Jam e kënaqur me rezultatin, besoj se do të punojë në të ardhmen që të përmirësohem edhe më shumë”, theksoi Kokaj.

Të dy skitaret ishin të vetmet që përfaqësuan Kosovën në EYOF.

Delegacioni i Kosovës për në EYOF Sarajeva 2019

Besim Hasani, president i KOK-ut
Shasivar Haxhijaj, sekretar i përgjithshëm i KOK-ut
Jeton Rudari, shef i misionit
Kushtrim Krasniqi, gazetar
Feim Kollçaku, trajner
Egzon Agani, trajner
Selim Maloku, sekretar i FSK-së
Elba Kokaj, skitare
Klea Vrella, skitare



EYOF Sarajeva 2019



Presidenti Hasani: Kosova në EYOF Sarajeva 2019 u prezantua si çdo shtet tjetër, u duartrokit në hapjen solemne

14 shkurt - Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka analizuar pjesëmarrjen e Ekipit Olimpik të Kosovës në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF), që po mbahet në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore.

Kosovën e përfaqësuan skitarët Klea Vrella dhe Elba Kokaj, të cilat të mërkurën përfunduan garat. Ato garuan në sllallom dhe sllallom të madh. Derisa në sllallomin e mbajtur të hënën, Klea doli nga shtegu, ndërsa Elba u diskualifikua, në sllallom të madh të mbajtur të mërkurës, ato zunë vendet 71 dhe 72.

“Bazuar në vlerësimin e trajnerëve dhe vetë garuesve, konkurrencës tejte të fortë, si dhe kushteve që mbretërojnë në vendin tonë, mund të themi se kishte një paraqitje të mirë të të dy skitareve. Për Kosovën është mirë që u prezantua në EYOF Sarajeva 2019, të cilat për vendin tonë ishin të dytat pas pjesëmarrjes në Erzurum 2017”, ka deklaruar presidenti Hasani për ueb-faqen zyrtare të KOK-ut, “noc-kosovo.org”.

Qëndrimin në Sarajevë, presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, e kanë shfrytëzuar edhe për takime të ndryshme me homologët e shteteve tjera, me të cilët shkëmbyen përvoja të ndryshme.

“Realizuar kontakte të shumta me homologët tanë, ndërsa për performancën e dy sportistëve dhe përvojën e fituar, edhe unë e ndaj mendimin me trajnerët dhe dy sportistët se të arriturat janë në proporcion me mundësitë për stërvitje dhe me kapacitetin momental të dy sportistëve. Jam i bindur se me investimet në Brezovicën e bukur dhe qendrat tjera, sportistët tona do të shkëlqejnë në vitet në vijim”, theksoi Hasani.

Bosnja e Hercegovina nuk e njeh Pavarësinë e Republikës së Kosovës, por kjo nuk ka pasur asnjë dallim sa i përket përfaqësimit të vendit tonë në Sarajevë, edhe pse federata të ndryshme të Kosovës kishin hasur në vështirësi, gjatë prezantimit të tyre të mëhershëm.

“Ne EYOF Sarajeva 2019 Kosova mori pjesë me flamur sikurse çdo shtet tjetër, madje në hapjen solemne duartrokitjet e qytetarëve të Bosnjës e Hercegovinës ishin frenetike që dëshmon respektin reciprok midis dy popujve dhe se shumica e qytetarëve nuk pajtohen me qëndrimet e politikanëve për mosnjohje të Republikës së Kosovës!”, shtoi i pari i Lëvizjes Olimpikë në Kosovë.

EYOF Sarajeva 2019 mbyllet nesër (e premte) mbrëma me ceremoninë mbyllëse, ku flamurin e Kosovës do ta bartë skitarja Klea Vrella.



Erzurum të Turqisë dhe Brod të Dragashit në Kosovë, ishin vendet ku u përgatitën ekipi ynë i skitarëve, falë shpenzimeve të hequra nga KOK-u

KOK ndanë edhe 41 mijë € për 18 bursistët Olimpikë Tokio 2020

8 shkurt - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, në mbledhjen e 30-të të saj, ka vendosur që të shtojë mbështetjen financiare për 18 bursistët Olimpik, të cilët po e ndjekin normën Olimpikë Tokio 2020.

Fillimisht Komisioni i Sportit i KOK-ut, raportoi për performancën e bursistëve në gjashtë muajt e fundit, derisa shprehu shqetësim në lidhje me mos raportimin e shumë federatave, përkundër kërkesës së bërë nga komisioni.

Bazuar në rezultatet e deritashme dhe pas propozimit të komisionit për t'i ndarë bursistët Olimpikë në tri grupe: evident, potencial dhe shpresë, BE i KOK-ut vendosi të shtojë mbështetjen financiare për përgatitje jashtë vendit për të tria këto grupe, në periudhën e ardhshme gjashtë mujore.

Vendimi vlen vetëm për përgatitje të sportistëve jashtë vendit dhe atë në kampe të verifikuara nga federatat përkatëse evropiane ose botërore.

Grupit të parë (evident) që përbëhet nga: Majlinda

Kelmendi (xhudo), Nora Gjakova (xhudo), Distria Krasniqi (xhudo), Akil Gjakova (xhudo), Lorian Kuka (xhudo), Herolind Nishevc (karate) dhe Alvin Karaqi (karate), u vendos që brenda gjashtë muajve të ardhshëm, t'i dërgojë në përgatitje jashtë vendit maksimumi 40 ditë, për të cilat shpenzimet do të hiqen në shumën 100 euro në ditë për një sportist.

Grupit të dytë (potencial), që përbëhet nga: Orges Arifi (karate) dhe Fortesa Orana (karate), KOK do t'ua heq shpenzimet maksimumi 20 ditë për një sportist, në vlerë 100 Euro në ditë.

Ndërsa, grupit të tretë (shpresë), në përbërje: Musa Hajdari (atletikë), Astrit Kryeziu (atletikë), Vijona Kryeziu (atletikë), Urata Rama (shenjëtari), Dasar Xhambazi (not), Fjorda Shabani (not), Atdhe Luzhnica (shigjetari), Edon Shala (mundje), Drilon Ibrahim (shenjëtari), t'u hiqen shpenzimet për 10 ditë përgatitje jashtë vendit në vlerë 100 Euro në ditë.

Në total, KOK do të ndajë 41 mijë Euro, nëse të gjithë bursistët shfrytëzojnë përgatitjet jashtë vendit brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Të 18 bursistët Olimpikë prej vitit 2017 marrin bursa Olimpikë nga Solidariteti Olimpik i Kosovës dhe Komitetit Olimpik i Kosovës.

BURSISTËT OLIMPIKË TOKIO 2020



Katër mbledhje të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut

Në tre muajshin e parë të vitit 2019 janë mbajtur katër mbledhje të Bordit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik të Kosovës. BE ka shqyrtuar një numër të madh të pikave të Rendit të Ditës.

Veçohen disa nga vendimet e dala, siç janë: përzgjedhja e Shpresave Olimpikë, marrja e vendimit për kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe trajnerëve për vitin 2019, bazuar në rekomandimin e komisionit për kategorizimin, zgjedhja e Laureatëve 2019, përgatitjet për EYOF Sarajeva 2019, mbështetja ekstra për Bursistët Olimpikë Tokio 2020, si dhe shumë çështje tjera.

KOK për herë të parë u jep bursë mujore Shpresave Olimpike 2019

28 janar - Komiteti Olimpik i Kosovës ka nënshkruar kontrata me gjashtë sportistë të rinj, të cilët janë përzgjedhur nga Bordi Ekzekutiv i KOK si bursistë për Shpresa Olimpike 2019.

Në ceremoninë e nënshkrimit të mbajtur në Hotel Sirius në Prishtinë, u bë e ditur se të gjashtë sportistët do të marrin bursa mujore nga 100 euro nga KOK-u për gjatë tërë vitit 2019.

Sportistët e përzgjedhur janë: Drenis Mala (shigjetari), Erdonis Maliqi (boks), Melisa Zhdrella (not), Bleron Fetaovski (peshëngritje), Blerton Nuha (çiklizëm) dhe Albinot Selmani (karate).

Krahas tyre u bë e ditur se KOK-u ka përzgjedhur edhe 10 sportistë tjerë të rinj si Shpresa Olimpike, të cilët do të marrin bursa nga Ministria për Kulturë, Rini e Sport, në vlerë 150 euro në muaj për gjatë vitit 2019. "KOK për herë të parë ka vendosur që të ndajë bursa për Shpresa Olimpike për vitin 2019. Ka vite të tëra që MKRS ndan bursa për Shpresa Olimpike dhe ato do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, por krahas kësaj, KOK në mbledhjen e vet ka vendosur që nga ky vit të vazhdojë të ndajë bursa për Shpresa Olimpike, të cilat ndahen nga mjetet e gjeneruara nga sponsorët e KOK-ut. Me këtë ne jemi duke përmbushur misionin e KOK-ut që sportistët të jenë në qendër të vëmendjes", tha presidenti Hasani.

I pari i KOK-ut kujtoi edhe Bursat Olimpik Toky 2020, në të cilën listë përfshihen 19 sportistë elitare.

10 sportistët që do të përfitojnë bursa nga MKRS në vlerë 150 Euro në muaj, si Shpresa Olimpik 2019

1. Erza Muminoviq (xhudo)
2. Shpat Zeka (xhudo)
3. Muhamet Ramadani (atletikë)
4. Betim Maliqi (karate)
5. Patriot Behrami (boks)
6. Dren Ukimeraj (not)
7. Arlind Selimi (mundje)
8. Arbi Pupovci (skitari)
9. Albina Deliu (atletikë)
10. Fatih Karabaxhaku (pingpong)

6 sportistët që do të përfitojnë bursa nga KOK në vlerë 100 Euro në muaj, si Shpresa Olimpik 2019

Drenis Mala (shigjetari)
Erdonis Maliqi (boks)
Melisa Zhdrella (not)
Bleron Fetaovski (peshëngritje)
Blerton Nuha (çiklizëm)
Albinot Selmani (karate)

Kosovo NOC for the first time gives a monthly scholarship to the 2019 Olympic Hopes

28.01.2019 - The Kosovo Olympic Committee has signed contracts with six young athletes, who have been selected by the Executive Board of the NOC as 2019

Olympic Hopes.

At the signing ceremony held at Hotel Sirius in Pristina, it was announced that the six athletes will receive monthly scholarships of 100 euros from NOC throughout 2019.

The selected athletes are: Drenis Mala (archery), Erdonis Maliqi (boxing), Melisa Zhdrella (swimming), Bleron Fetaovski

(weightlifting), Blerton Nuha (cycling) and Albinot Selmani (karate).

In addition, it was also announced that NOC has selected 10 other athletes as Olympic Hopes, who will receive scholarships from the Ministry of Culture, Youth and Sports throughout 2019, worth 150 euros per month.





Bursat Olimpike 2019: Fjorda Shabani zëvendëson Flaka Pruthin

28 janar - Bazuar në kontratën e nënshkruar në tetor të vitit 2017 ndërmjet KOK-ut, sportistit dhe federatës përkatëse, u bënë ndryshime në listën e 19 bursistëve Olimpik Tokio 2020.

Pas kërkesës së bërë nga Federata e Notit e Kosovës, BE i KOK-ut vendosi që talentja e notit, Fjorda Shabani të zëvendësojë bursisten tjetër nga ky sport, Flaka Pruthi.

"Kohëve të fundit kemi kërkuar nga federatat raportin e performancës së sportistëve, nëse sportistët janë në rrugën e duhur për të fituar normën Olimpikë. Disa raporte vetëm sa i kemi analizuar dhe për shkak të performancës jo të kënaqëshme kemi vendosur t'ia ndërprejmë bursën Olimpikë notares, Flaka Pruthi, të cilën kemi vendosur ta zëvendësojmë me 14-vjeçaren e talentuar, Fjorda Shabani. Bursa mujore që do t'i ndahet Fjordës është 150 dollarë nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe 100 euro nga Komiteti Olimpik i Kosovës", tha sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj.

Ai bëri me dije që sportistët të cilët nuk kanë performancë të duhur do t'iu ndërpritet bursa.

Sipas Haxhijajt, listës së bursistëve mund t'i shtohet cilido sportistë tjetër që fiton medalje botërore ose evropiane.

Fjorda Shabani falënderoi KOK-un për bursën, duke theksuar se: "Ky është motiv më i madh për të arritur nivele më të mëdha".



Boksieres Donjeta Sadiku i mundësohet sërish marrja e bursës Olimpike Tokio 2020

20 mars - Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar u ka mundësuar sërish boksierëve të marrin bursën Olimpikë për Lojërat Olimpikë Tokio 2020, pas pezullimit që u kishte bërë vitin e kaluar.

Vendimi është marrë pas diskutimeve të Bordi Ekzekutiv të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, të cilët kanë rënë dakord për të "hequr ngrirjen e financimit të Solidaritetit Olimpik për sportistët e boksit, me kusht që të mos kërkojnë fonde tjera ose pagesat të mos bëhen përmes federatës kombëtare të boksit".

Me këtë rast, boksierja e vetme në listën e bursistëve Olimpik të Komitetit Olimpik të Kosovës është Donjeta Sadiku.

Sipas njoftimit të Solidaritetit Olimpik fondet duhet të shkojnë direkt tek sportistja dhe në këtë rast nuk duhet të përfshihet edhe federata.

Që prej 3 majit të vitit të kaluar, Sadikut i ishte ndaluar Bursa Olimpikë nga SO i KON-it për shkak të mospajtimeve që kishte Komiteti Olimpik Ndërkombëtar me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (AIBA).

Vendimi për të aktivizimin e bursës Olimpikë të kampionës së Evropës 2016 për të reja, hyn në fuqi prej janarit 2019, të cilin vendim do ta zbatojë KOK-u. Donjeta përfiton 500 dollarë në muaj nga SO i KON-it.



www.toyota-kosovo.com

Badmintoni u certifikua në kursin për administratorë sporti

14 janar - Federata e Badmintonit e Kosovës ka përfunduar me sukses kursin bazik për administratorë të sportit, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Dhjetëra zyrtarë të federatës, trajnerë e lojtarë për tri ditë radhazi mësuan për realizimin e planit strategjik 2019-2020, dhe gjerësisht u fol për ciklin që mbyllet në vitin 2024, si shtrirje kohore e planit strategjik të Federatës së Badmintonit të Kosovës.

Vijues i kursit ishte edhe kryetari i kësaj federate, Jeton Nebiu, i cili u shpreh falënderues ndaj KOK-ut për organizimin e këtij kursi, që u mbajt në Hotel Sirius në Prishtinë.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritete Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-KON/drejtor programi, Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, kurse për Hulumtimin Shkencor: "Lartësia e trupit në raport me parametrat tjerë Antropometrik për popullatën në Kosovë", ligjëroi PHD Fitim Arifi.

Federata e Badmintonit e Kosovës u themelua vitin e kaluar, ndërsa u bë anëtare e KOK-ut me të drejta të plota në Asambleenë Vjetore të Punës të mbajtur më 21 dhjetor 2018.

Ky ishte kursi i parë bazik për këtë vit i organizuar nga KOK-u, ndërsa i 19-ti që nga viti 2017.





Shahu u certifikua në kursin për administratorë sporti, vijuesit vlerësuan lartë kursin



11 mars - Shahu është federata e radhës që është certifikuar në kursin për administratorë sporti, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe të mbajtur për tri ditë radhazi në Hotel Sirius në Prishtinë.

25 administratorë, zyrtarë, shahistë, në mesin e tyre edhe kryetari i Federatës së Shahut të Kosovës, Nystret Avdiu, morën certifikata të nënshkuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. Ata mësuan për realizimin e planit strategjik 2018-2020, si dhe u bashkëbisedua për ciklin që mbyllet në vitin 2024.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritet Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-KON/drejtor programi, Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, kurse për trajnimin mental ligjëroi trajneri i njohur i futbollit në Kosovë, Fetah Veliu.

“Në vazhden e kurseve që po i mbajmë me organizatat sportive, këtë herë kishim Federatën e Shahut të Kosovës, pjesëmarrësit e së cilës kanë një përshtypje të mirë. Ne i ndamë eksperiencat tona, të cilat janë menaxhimi i organizatave sportive në mënyrë strategjike dhe vlerësoj se kanë marrë njohuri të mjaftueshme strategjike dhe në të njëjtën kohë janë impenjuar të

bëjnë një plan strategjik në organizatën e tyre, me qëllim që të punohet me plan strategjik, ku ndër to është edhe aspekti i menaxhimit të burimeve njerëzore”, deklaroi ligjëruesi Ibër Alaj.

Edhe pjesëmarrësit vlerësuan lartë organizimin e kursit nga KOK-u. “Mendoj se është dashur ndoshta edhe një ditë ose dy t’i kishim në dispozicion. Vërtetë është punuar mire. Interesimi i pjesëmarrësve është i madh dhe përshtypjet janë shumë të mira, edhe pse kemi pritur pjesëmarrje edhe më të madhe”, u shpreh Nystret Avdiu, kryetar i FSHK-së.

“Për mua është një kujtim i ri i jetës dhe përvojës jetësore që na ka lënë përshtypje shumë të mira dhe na ka mësuar gjëra shumë të mira. Kjo është një punë shumë e mirë dhe është vetëm një nisje e këtij hapi. Ata që duan më shumë në jetë duhet ta ndjekin këtë kurs”, u shpreh Ekrem Gashi nga KSH Ulpiana.

Shehrije Gërbeshi, kryetare e klubeve të shahut për femra, theksoi se një kurs i tillë i ka munguar komunitetit të shahut, derisa ajo dhe vijuesit tjerë morën njohuri të reja menaxhuese.

Shahu është federata e 21-të që ndjeku këtë kurs, që ka nisur të organizohet prej vitit 2017, dhe që mbështetet nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.



Mbyllet me sukses kursi i 20-të me radhë për administratorë sporti, certifikohet bjeshkataria alpiniste

04 shkurt - Federata Bjeshkatore Alpiniste e Kosovës ka përfunduar me sukses kursin bazë për administratorë të sportit, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Dhjetëra zyrtarë të federatës dhe shoqatave bjeshkatore për tri ditë radhazi mësuan për realizimin e planit strategjik 2018-2020, dhe gjerësisht u fol për ciklin që mbyllet në vitin 2024, si shtrirje kohore e planit strategjik të Federatës Bjeshkatore Alpiniste të Kosovës.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritete Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-KON/drejtor programi, Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, kurse për Hulumtimin Shkencor. "Lartësia e trupit në raport me parametrat tjerë Antropometrik për popullatën në Kosovë", ligjëroi PHD Fitim Arifi.

"Ky është kursi i 20-të bazë për administratorët e sportit. Interesimi i Federatës Bjeshkatore Alpiniste ishte i jashtëzakonshëm. Jam i bindur që këto njohuri do t'ju shërbejnë atyre për ta parë rëndësinë e planit strategjik dhe

ta përpilojnë strategjinë e tyre për ciklin e ardhshëm olimpik 2021-2024", tha presidenti Hasani për Kosova Press.

Vijues i kursit ishte edhe kryetari i kësaj federate, Arben Lila, i cili u shpreh falënderues ndaj KOK-ut për organizimin e këtij kursi, që u mbajt në Hotel Sirius në Prishtinë. "Përfitimet janë të shumë të rëndësishme jo vetëm për federatën, por për të gjitha klubet dhe shoqatat bjeshkatore. Është një kurs që na tregon se si ta kemi rrugëtimin tonë për pesë vitet e ardhshme", u shpreh Lila.

Vijuesja tjetër e këtij kursi, Alisa Hasani, theksoi se: "Informatat që I kemi marrë kanë me na ndihuar me u zhvilluar më tutje edhe si shoqatë edhe si federate".

Ky ishte kursi i dytë bazë për këtë vit i organizuar nga KOK-u, ndërsa i 20-ti që nga viti 2017.



Aeronautika, federata e 22-të e certifikuar në kursin për administratorë sporti



25 mars - Federata Aeronautike e Kosovës ka kryer me sukses kursin për administratorë sporti, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe të mbajtur për tri ditë radhazi në Hotel Sirius në Prishtinë.

Dhjetëra zyrtarë të federatës dhe klubeve morën certifikatën e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.

Ata mësuan për realizimin e planit strategjik 2019-2020, si dhe u bashkëbisedua për ciklin që mbyllet në vitin 2024.

Ligjërues të rregullt ishin: Besim Hasani (MEMOS XVIII) drejtor i programit për kurse/Solidaritët Olimpik-Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, Ibër Alaj (MEMOS XIX) SO-KON/drejtor programi, Elda Gjoka (MEMOS IX) drejtoreshë e kursit kombëtar, licencuar gjithashtu nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, kurse për trajnimin mental ligjëroi trajneri i njohur i futbollit në Kosovë, Fetah Veliu.

“Në këto katër vjet KOK ka kryer një rrugë shumë të madhe për ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin e anëtarësisë së federatave sportive në Kosovë, për të pasur plan strategjik, për të folur të gjithë me një gjuhë me konceptet

bashkëkohore strategjike dhe me i diskutuar me ta parimet se si ndërtohet strategjia”, u shpreh ndër të tjera, Elda Gjoka.

Kryetari i kësaj Federatës Aeronautike të Kosovës, Artan Venhari – u shpreh i lumtur me ecurinë e këtij kursi, duke cilësuar ligjëruesit si profesionist në këtë fushë, pasi sipas tij janë duke e kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme. “Ky është një kurs mjaft interesant që iu duhet të gjitha federatave. Plani strategjik iu ndihmon të gjitha federatave, jo vetëm për t’i zhvilluar kapacitetet në këtë moment, por për të krijuar një vizion afatgjatë dhe për t’i paraprirë zhvillimit afatgjatë të të gjitha federatave dhe klubeve”, theksoi Venhari.

Ky ishte kursi i 22-të i organizuar për federatat sportive, dhe i mbështetur nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.



Profesoresha e MEMOS, Tracy Taylor, ligjëroi në modulën 6 të kursit ASMC 1

23.02 - Profesoresha e Masterit Ekzekutiv të Menaxhimit të Organizatave Sportive (MEMOS), Tracy Taylor nga Australia, ligjëroi në Kursin e Avancuar për Menaxhimin Sportiv (ASMC 1), i cili për herë të parë po mbahet në Kosovë dhe po organizohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Në shkurt u mbajt moduli 6 i këtij kursi, që ka nisur në maj të vitit të kaluar, derisa ASMC 1 numëron 9 module. Në kurs po marrin pjesë presidentë dhe sekretarë të përgjithshëm të federatave sportive në Kosovë.

Taylor ligjëroi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Organizatat Sportive, duke sjell përvojën e saj shumëvjeçare në Kosovë.

“Jam shumë e nderuar që ndodhem në Kosovë. Jam këtu për t’i dhënë mbështetje Komitetit Olimpik dhe Federatave Sportive, për t’u siguruar se ata strukturalisht janë në rrugën më të mirë. Kursi ASMC 1 ofron njohuri në ndërtimin e kapaciteteve me organizatat sportive për t’i dhënë mbështetje sportit në vend. Unë jam këtu për të ligjëruar për aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke këshilluar dhe duke u dhënë mundësi atyre”, u shpreh Taylor.

Ajo është profesoreshë edhe në Unitversitetin e Teknologjisë së Sydneyt në Australi.

Ligjërues të përhershëm të kursit janë edhe: Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, Ibër Alaj, drejtor i Departamentit të Sportit

në MKRS, MEMOS 19 dhe Elda Gjoka, drejtoreshë kombëtare për organizimin e kurseve bazike për administratorë të sportit, MEMOS 9.

Të gjithë ligjëruesit janë të certifikuar nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar për të ligjëruar në kurse të tilla.

Presidenti i KOK-ut, vlerësoi lartë ardhjen e Tracy Taylorit në Kosovë.

“Bazuar në planin strategjik të KOK-ut për pjesën e menaxhimeve të burimeve njerëzore, jemi duke punuar me kursin e avancuar, ku po marrin pjesë sekretarë të përgjithshëm dhe presidentët të Federatave të ndryshme. Ky është moduli i gjashtë, kemi të bëjmë me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe jemi të nderuar që këtu është një profesoreshë e masterit ekzekutiv që është nën patronatin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, profesoresha nga Australia, Tracy Taylor, e cila sot po e ndanë tërë eksperiencën e saj me ne”, delaroi presidenti Hasani.

Ai shtoi se: “Këto përvoja të jashtëzakonshme që profesoresha po i ndanë, mund të përkthehen në përfitime të shumta për çdo federatë dhe për KOK-un, sepse çdo gjë është lehtë e zbatueshme në federatë, mjafton me i përcjellë parimet dhe principet të cilat shpjegohen këtu”.

Taylor do të ligjërojë edhe të dielën, kur edhe do të mbyllet moduli i gjashtë, i cili po mbahet në Hotel Sirius në Prishtinë.



MEMOS Professor, Tracy Taylor, lectured on ASMC 1 Course

23.02.2019. The Professor of the Executive Masters in Sport Organization Management (MEMOS), Tracy Taylor from Australia, lectured on the Advanced Sports Management Course (ASMC 1), which was held in Kosovo for the first time and was organized by the Kosovo Olympic Committee.

At the weekend (21st – 23rd February, 2019), Module 6 of the course started, which had begun in May last year, while ASMC 1 has 9 modules. This course is being attended by presidents and general secretaries of sports federations in Kosovo.

Taylor is lecturing on Human Resource Management in Sports Organizations, bringing her many years of experience in Kosovo.

"I am honored to be in Kosovo. I am here to support the Olympic Committee and the Sports Federations, to make sure that they are structurally walking on the best path. The ASMC 1 course offers knowledge on capacity building with sport organizations in order to provide sport support in the country. I am here to lecture on aspects of human resource management, by counseling and giving them opportunities," said Taylor.

She is also a professor at the University of Technology in Sydney, Australia.

The President of NOC Kosovo, Besim Hasani highly praised the arrival of Tracy Taylor in Kosovo.

"Based on the strategic plan of NOC for the human resource management part, we are working with the advanced course, which is attended by general secretaries and presidents of various federations. This is module number six, in which we are dealing with human resource management. Moreover, we feel honored by the presence of the executive master professor, Tracy Taylor from Australia, who is sharing the whole experience with us today under the patronage of the International Olympic Committee," said President Hasani.





Kosova drejt Minsk 2019

Ekipi Olimpik i Kosovës do të marrë pjesë për herë të dytë në Lojërat Evropiane Minsk 2019.

Kosova pritet të paraqitet me një ekip të gjerë, gjersa synon të fitojë sa më shumë medalje.

Lojërat Evropiane Minsk 2019, mbahen prej 21-30 qershor në kryeqytetin e Bjellorusisë.

Xhudo, karate, boksi, mundja, pingpongu, pritet të përfaqësojnë vendin tonë në Lojërat e dyta Evropiane.

Deri më tani, Kosova ka vetëm një medalje të fituar nga Lojërat Evropiane. Ishte xhudistja, Nora Gjakova, që fitoi të bronztën në Baku 2015.



DONJETA SADIKU

© Klubi i Boksit Gollaku



Boksieres, Donjeta Sadiku, i rezervohet një vend në Lojërat Evropiane Minsk 2019

23 janar - Boksieres Donjeta Sadiku i është rezervuar një vend për pjesëmarrje në Lojërat e dyta Evropiane Minsk 2019, që mbahen prej 21-30 qershor në Minsk të Bjellorusisë. Organizatori i ka konfirmuar Komitetit Olimpik të Kosovës pjesëmarrjen me ftesë boksieres tonë, e cila do të garojë në kategorinë deri në 60 kilogramë.

Sadiku ishte bërë nënkampione e botës për juniore në vitin 2015 në Taipei të Tajlandës, ndërsa një vit më pas fitoi medaljen e artë në Kampionatin Evropian në Ordu të Turqisë, kategoria -57 kilogramë.

Në dy vitet e fundit, Donjeta ishte e pafat, pasi iu mohua pjesëmarrja në Kampionatin Botëror për juniore në vitin 2017 dhe vitin e kaluar në botërorin e senioreve. Të dy kampionatet u mbajtën në New Delhi të Indisë, shtet ky që ekipin e Kosovës nuk e pajisi me viza, shkaku i mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga India.

9	PERJOC Lacramioara	ROU	1
10	ZEKIC Jelena	SRB	1
11	BRUYEVICH Helina	BLR	1*
12	BERAM Sara	CRO	1**
		TOTAL:	12
QUALIFIED FOR RESERVE***			
13	BURCU Sati	TUR	
14	MESIANO Alessia	ITA	
15	COROLI Iulia	MDA	

Weight Category: Light -60kg

Qualifying Rank	Name of Athlete	NOC	Number of Quota Places
1	HARRINGTON Kellie Anne	IRL	1
2	POTKONEN Mira	FIN	1
3	ELISEEVA Denitsa	BUL	1
4	BELIAKOVA Anastasiia	RUS	1
5	ALEXIUSON Agnes	SWE	1
6	RYGIELSKA Aneta	POL	1
7	YARSHEVICH Ala	BLR	1*
8	TSYPLAKOVA Iuliia	UKR	1
9	CRAVENCO Cristina	MDA	1
10	TESTA Irma	ITA	1
11	PROSTOMOLVA Daria	BLR	1
12	SADIKU Donjeta	KOS	1**
		TOTAL:	12
QUALIFIED FOR RESERVE***			
13	HUMLOVA Katerina	CZE	
14	MEZOVARI Kinga	HUN	
15	COSMA Cristina	ROM	

Lojërat Evropiane Minsk 2019 - Kalendari i garave

EVENT										
	21 Fri	22 Sat	23 Sun	24 Mon	25 Tue	26 Wed	27 Thu	28 Fri	29 Sat	30 Sun
 OPENING CEREMONY Dinamo Stadium										
 CLOSING CEREMONY Dinamo Stadium										
 3X3 BASKETBALL Palova Arena										
 ARCHERY Olympic Sports Complex										
 ATHLETICS Dinamo Stadium										
 BADMINTON Falcon Club										
 BEACH SOCCER Olympic Sports Complex										
 BOXING Uruchie Sports Palace										
 CANOE SPRINT Zaslavl Regatta Course										
 CYCLING ROAD Minsk										
 CYCLING TRACK Minsk Arena										
 GYMNASTICS ACROBATIC Minsk Arena										
 GYMNASTICS AEROBIC Minsk Arena										
 GYMNASTICS ARTISTIC Minsk Arena										
 GYMNASTICS RHYTHMIC Minsk Arena										
 GYMNASTICS TRAMPOLINE Minsk Arena										
 JUDO Chizhovka Arena										
 KARATE Chizhovka Arena										
 SAMBO Sports Palace										
 SHOOTING RIFLE & PISTOL Shooting Centre										
 SHOOTING SHOTGUN Sporting Club										
 TABLE TENNIS Tennis Olympic Centre										
 WRESTLING Sports Palace										

21 MEDALJE PËR TRE MUAJ

21 është numri i medaljeve ndërkombëtare të fituara nga sporti i xhudos, përfshirë edhe 10 sosh në kampionatin ballkanik të mbajtur në Tiranë

Edhe viti 2019 nisi me medalje për sportin më të suksesshëm në Kosovë. Xhudo i solli vendit tonë 21 medalje në 90 ditët e para të vitit 2019. Majlinda Kelmendi u veçua për dy të artat e fituara në Grand Prixin e Tel Avivit, si dhe atë të Dyseldorfit të Gjermanisë.

Nora Gjakova fitoi të artën në Tbilisi të Gjeorgjisë, bashkë me Lorian Kukën.

Distria Krasniqi, suksesin më të madh e pati në Grand Slamin e Parisit, ku para 15 mijë shikuesve fitoi medaljen e argjendtë. Në këtë Grand Slam, Akil Gjakova doli i pesti.

Medalje me bollëk sollën edhe nga Tirana, ku u mbajt kampionati ballkanik.

Gjithësej 10 sosh i fitoi ekipi ynë i xhudos. Erza Muminoviq (-48 kg), Distria Krasniqi (-52 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg), si dhe Shpati Zekaj (-100 kg), fituan të artat.

MAJLINDA KELMENDI

“Të jem e singertë, sot (të premten) isha shumë e motivuar. Kisha disa ndjenja, si të isha në Olimpiadë. Isha e motivuar dhe e dija saktësisht çfarë duhej të bëja”, kishte deklaruar ndër të tjera, Majlinda Kelmendi, pas medaljes së artë të fituar në Grand Slamin e xhudos, që u mbajt në Dyseldorf.

“To be honest, today (on Friday) I was very motivated. I had some feelings like being in the Olympics. I was motivated and knew exactly what I had to do,” said among others Majlinda Kelmendi, after she won the gold medal at the Grand Slam of Judo, held in Dusseldorf.





21 medals in three months

21 is the number of international medals won by the sport of judo, including 10 medals in the Balkan championship held in Tirana

Even 2019 started with medals for the most successful sport in Kosovo. Judo brought our country 21 medals in the first 90 days of 2019.

Majlinda Kelmendi was distinguished for the two gold medals won in the Grand Prix of Tel Aviv and that of Dusseldorf, Germany. Nora Gjakova won the gold medal in Tbilisi, Georgia, along with Loriana Kuka.

The greatest success of Distria Krasniqi was in the Grand Slam of Paris, where she won the silver medal in front of an audience of 15,000 viewers. In this Grand Slam, Akil Gjakova came out the fifth.

Abundant medals were also brought from Tirana, where the Balkan championship was held.

Altogether 10 medals were won by our judo team. Erza Muminoviq (-48 kg), Distria Krasniqi (-52 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg), and Shpati Zekaj (-100 kg) won the gold ones.



"Deri në vitin 2016 kisha tre sponsorë, prej vitit 2016 kur fitova medaljen e artë Olimprike, e kam vetëm një sponsor!", Majlinda Kelmendi

"By 2016 I had three sponsors. Since 2016 when I won the Olympic gold medal, I have only one sponsor!" said Majlinda Kelmendi.





Distria e argjendtë, Akili i pesti në Grand Slamin e Parisit

Një medalje e argjendtë dhe një vend i pestë është bilanci i suksesit të xhudistëve tanë në Grand Slamin e Parisit.

09 shkurt - Medaljen e argjendtë e fitoi Distria Krasniqi në kategorinë deri në 48 kilogramë, ndërsa vendin e pestë e zuri, Akil Gjakova, në kategorinë deri në 73 kilogramë.

Kampionia e Evropës, Nora Gjakova, nuk e kishte ditën, pasi u ndalë në luftën e parë nga Jisu Kim e Koresë së Jugut, kategoria deri në 57 kilogramë. Kjo treshe përfaqësoi ekipin e xhudos në Paris.

Në një konkurrencë të fortë, Distria pas katër fitoreve arriti në finale, ku humbi nga japonezja, Ami Kondo. Ndërkohë, Akili, që vitin e kaluar fitoi të artën në këtë Grand Slam, këtë herë udhëtimi i suksesshëm u ndal pas tri fitoreve, konkretisht në gjysmëfinale dhe në luftën për të bronzën, ku u mposht nga medalisti i artë Olimpik nga Rio 2016, Fabio Basile.

Krasniqi fitoi 700 pikë Olimpike për Tokio 2020, ndërsa Akili 360 sosh.

Gara e Grand Slamit të Parisit vlerësohet si ndër më të fortat në xhudo, kurse luftërat e sotme u ndoqën nga rreth 15 mijë të pranishëm.



Nora e Lorian, vajzat e arta në Tbilisi

Nora Gjarkova ka mposhtur medalisten e artë Olimpikë Rio 2016, brazilianen Rafaela Silva, për të fituar medaljen e artë në Grand Prixin e Tbilisit të Gjeorgjisë.

29 mars - Kampionia evropiane triumfoi në finale ndaj Silvas, pas tri vërejtjeve të marra nga kundërshtarja e saj në shënim të artë, kategoria deri në 57 kilogramë.

Deri tek medalja e artë, Nora erdhi pas katër luftërave të fituara. Për Norën është kjo medalja e parë e fituar këtë vit.

Dy ditë pas saj, medaljen e artë e fitoi edhe Lorian Kuka, kategoria – 78 kilogramë. Garuesja jonë në finale mposhti Kliema Antomarchi të Kubës. Antomarchi, dy vjet më parë ishte medaliste e bronzit në botërorin e Budapestit. Në përgjithësi, Lorian fitoi katër luftëra.

Nora dhe Lorian fituan nga 700 pikë të reja për Lojërat Olimpikë Tokio 2020.

Majlinda e nis 2019-tën me medaljen e artë, Lorian me të argjendtën

Majlinda Kelmendi e ka nisur në mënyrën më të mirë vitin 2019. Kampionia jonë Olimpikë fitoi medaljen e artë në Grand Prixin e xhudos, që po mbahet në Tel Aviv të Izraelit.

24 janar - Kelmendi mposhti në finale izraeliten, Gili Cohen, kategoria deri në 52 kilogram.

Në përgjithësi, Majlinda shënoi katër fitore dhe të gjitha me ippon. Në luftën e parë mendi gjeorgjianen, Tetiana Levytska Shukvani, në çerekfinale mposhti zviceranën, Fabienne Kocher, ndërsa në gjysmëfinale rumunen, Andrea Chitu.

Me medaljen e artë ajo shtoi në llogarinë e saj edhe 700 pikë Olimpikë për Lojërat Olimpikë Tokyo 2020.

Dy ditë më pas, Lorian Kuka ka fituar medaljen e argjendtë. Xhudistja jonë u mposht në finale me shënim të artë nga sllovenja, Klara Apotekar, në kategorinë deri në 78 kilogramë.

Kuka shënoi tri fitore. Në luftën e parë mendi holandezen Llona Lucassen, në çerekfinale kaloi Aleksandra Babintseva (Rusi), ndërsa në gjysmëfinale mposhti Natalie Poëel (Britani e Madhe). Lorian fitoi 490 pikë Olimpikë për Lojërat Olimpikë Tokyo 2020.

Majlinda 'pushtoi' edhe Dyseldorfin

22 shkurt - Majlinda Kelmendi ka vazhduar me formën e mirë në vitin 2019, duke fituar medaljen e dytë të artë këtë vit. Kampionia Olimpikë dhe e botës, fitoi të artën në Grand Slamin e xhudos, që po mbahet në Dyseldorf të Gjermanisë, kategoria deri në 52 kilogramë.

Në finale, kampionia jonë mposhti Sosorbaram Lkhagvasuren të Mongolisë. Deri në finale ajo shënoi edhe katër fitore tjera. Në gjysmëfinale mendi medalisten e argjendtë të Lojërave Olimpikë Rio 2016, italianen Odette Giuffrida, të cilën e kishte mposhtur vetë. Para saj kaloi edhe medalisten tjetër të argjendtë nga Rio 2016, por në kategorinë -48 kg, Bokyeong Jeong (Korea e Jugut).

Në rrethin e dytë dhe të tretë (rrethin e parë e kaloi pa luftë), Majlinda mposhti Verena Thumm të Gjermanisë dhe Eleudis Valentim të Brazilit.

Kelmendi fitoi 1000 pikë Olimpikë për Lojërat Olimpikë Tokio 2020. Për të është medalja e dytë e artë këtë vit, pas asaj të fituar muajin e kaluar në Grand Prixin e Tel Avivit.

Në Grand Slamin e Dyseldorfit, ekipi i Kosovës u paraqit vetëm me Majlindën.



Kuka e argjendtë në Marrakech, Kasapi fiton medaljen e parë në karrierë

Loriana Kuka ka fituar medaljen e argjendtë në Grand Prixin e xhudos Marrakech 2019 të Marokut.

10 mars - Xhudistja jonë pësoi humbje në finale nga gjermanja Ana Maria Ėagner, kategoria deri në 78 kilogramë. Deri në finale, Loriana fitoi tri luftëra, ndërsa raundin e parë e kaloi pa luftë. Kuka fitoi 490 pikë

Olimpikë për Lojërat Olimpikë Tokio 2020. Medalje të argjendtë, të parën në karrierë e ka fituar sot edhe Fationa Kasapi, në Kupën Evropiane për kadete, që u mbajt në Zagreb të Kroacisë. Kasapi shënoi pesë fitore me ippon, kategoria -57 kg. Në këtë garë, medalistja e bronzitë në Lojërat Olimpikë për të rinj, Erza Muminoviq, zurin vendin e shtatë, kategoria -48 kg. Arbër Nikçi u ndal në luftë e parë.



Dy arta dhe një e bronzitë në Kupën evropiane për juniore

Erza Muminoviq dhe Flaka Loxha i kanë sjellur dy medalje Kosovës në Kupën evropiane të xhudos për juniore (U21), që u mbajt në Athinë të Greqisë.

23 mars - Erza fitoi të artën falë pesë fitoreve, katër me luftë, kategoria deri në 48 kilogramë.

Medalistja e bronzitë Olimpikë për të reja, në finale mposhti austriaken, Jaqueline Springer.

Flaka po ashtu shënoi pesë fitore, katër me luftë. Në finale të kategorisë deri në 57 kilogramë ajo mundi austriaken, Losa Grabner. Në kategorinë e njëjtë, Fationa Kasapi u eliminua në rrethin e parë.

Laura Fazliu (-63 kg) humbi luftën për medaljen e bronzitë, duke përfunduar e pesta.

Shpresa Olimpikë 2018, xhudisti Shpat Zekaj (-100 kg) fitoi medaljen e bronzitë në Kupën evropiane për junior, që po mbahet në Athinë të Greqisë. Shpati shënoi tri fitore. Arbër Kullashi (-81 kg) fitoi katër luftëra dhe zuri vendin e shtatë.

Ekipi ynë i xhudos, u kthye nga Athina me dy të arta, një të bronzitë dhe një vend të pestë.





Pesë normat Olimpikë synojnë medalje në Minsk 2019

Trajneri kampion Olimpik, Driton Kuka, flet në intervistën për Olimpin, rreth sukseseve në tre mujorëshin e parë të vitit 2019, pesë normat Olimpikë, synimet për në Lojërat Evropiane Minsk 2019, etj

Hiq më pak se pesë është numri i garuesve të xhudos, të cilët momentalisht qëndrojnë brenda normës Olimpikë Tokio 2020. Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Lorian Kuka dhe Akil Gjakova, ndodhen në top 10-shen e renditjes Olimpikë të xhudos nëpër kategoritë e tyre.

Kjo pesësje në tre muajt e ardhshëm do të garojë në gara të ndryshme, ndërsa veçohen Lojërat Evropiane Minsk 2019, në të cilat falë tyre, Kosova synon edhe medaljen e artë.

Arkitekti i këtij suksesi, Driton Kuka, flet në intervistën për Olimpin.

E nisët mjaftë mirë edhe vitin 2019. Si ishte ky tre mujorësh për xhudon?

2019 ka nis mbarë dhe besoj që do vazhdoj kështu gjatë krejt vitit. Ekipi ynë, tre muaj pothuajse të gjithë janë duke ecur siç e kam planifikuar. Secili prej tyre po ec drejt Olimpiadës. Norma Olimpikë është caku ynë kryesor deri në Tokio e kjo punë po ec mirë.

Majlinda në dy gara fitoi dy të arta. Cila është gjendja e saj në aspektin e rehabilitimit nga lëndimi dhe a po rikthehet ajo në formën më të mirë?

Majlinda është rikthyer fuqishëm. Probleme të vogla ka ende, por në gara ka pasur paraqitje të mirë. Ende duhet punë të arrijë aty ku dua, në formën e saj.

Momentalisht kemi pesë norma Olimpikë Tokio 2020, të gjitha nga xhudo. A e keni pritur që afër 1 vit e gjysmë para LO Tokio 2020, të pesë xhudistët të jenë brenda normës, duke përfshirë edhe Lorianën, e cila në skenë doli vetëm 2-3 vjet më parë?

Po, pesë norma dhe që të gjithë në Top 10. Kjo është e pabesueshme, por loja vazhdon edhe për një vit e pak muaj. Për Lorianën nuk kam pritur që do të jetë brenda normës. Ajo në këto 7-8 muaj na ka befasuar për të mirë, është potencial i madh edhe për shumë kohë.

Para LO Tokio 2020, i kemi Lojërat Evropiane Minsk 2019. A do të marrin pjesë të pesë xhudistët dhe nëse po, sa medalje mund të presim?

Në Minsk besoj që të gjithë do të paraqiten. Normalisht, gjasat janë për medalje dhe besoj që do të kthehemi me medalje, sa e qysh mbetet të shihet. Në xhudo, Lojërat Evropiane janë edhe Kampionat Evropian, domethënë do të jetë shumë garë e fortë!

Krahas Minsk-ut, çfarë prisni ju nga garat tjera të xhudos deri në përfundim të 2019-ës, përfshirë edhe botërorin që mbahet në Tokio?

Sivjet e kemi kampionatin botërorin (Tokio 2019), ku synojmë medalje nga atje. Është gara më e fortë për ne sivjet.

Intervistoi: Kushtrim Krasniqi





Pozita momentale (31 mars) e xhuditëve tanë në renditjen Olimprike

View

Nation ☒ Show all nations

Search by name

Simple

Expanded

☒ Kosovo (KOS)

Note: the information shown is **provisional** and only shows which judoka would be qualified, if the Olympic Games were today. The list will likely change significantly **until 25th May 2020**, which is the deadline for obtaining points for Olympic qualification.

Place	Competitor	Points	Qualification status
#1 in -48	 KRASNIQI Distria	2300 points	Qualified
#3 in -57	 GJAKOVA Nora	2111 points	Qualified
#7 in -52	 KELMENDI Majlinda	1550 points	Qualified
#6 in -73	 GJAKOVA Akil	1519 points	Qualified
#10 in -78	 KUKA Lorian	1246 points	Qualified

Karateistët fituan dy medalje evropiane në Aalborg 2019

Kombëtarja e karatesë për të rinj u rikthye me dy medalje nga kampionati evropian, i mbajtur në Aalborg të Danimarkës.

08-10 shkurt - Karateisti Melos Gashi ka arritur sukses të jashtëzakonshëm, duke fituar medaljen e argjendë në kategorinë e kadetëve.

Ai e arriti të shkëlqejë në kategorinë e kadetëve mbi 70 kilogram, në një konkurrencë shumë të fortë. Melosi mposhti katër garues, për të fituar medaljen e argjendtë. Në finale, Gashi u mund nga Ahmet Bulut nga Turqia.

Ndërkohë, Albulena Gërvalla, ka fituar medaljen e bronzit për U-21, kategoria deri në 55 kilogramë.

Deri tek medalja e bronzit, karateistja jonë erdhi përmes repesazhit, ku shënoi tri fitore, ndërsa një tjetër e kishte arritur në luftën e parë.

Kombëtarja e karatesë u paraqit me 25 garues në evropian.

Karate won two European medals in Aalborg 2019

The youth karate national team returned with two medals from the European championship held in Aalborg, Denmark.

The Karateist, Melos Gashi, has achieved tremendous success by winning the silver medal in the category of cadets.

He managed to shine in the very strong competition of over 70 kilograms in the cadet category. Melosi beat four contestants winning so the silver medal. In the final, Gashi was defeated by Ahmet Bulut from Turkey.

In meanwhile, Albulena Gërvalla, won the bronze medal for U-21, the category of up to 55 kilograms.

Up to the bronze medal, our karateist came through repatriation, where she ensured three victories, whereas another victory she had achieved in her first fight.

Karate national team was represented by 25 competitors in the European.



Pamje nga konferenca për shtyp e FKK-së pas kthimit nga kampionati evropian

Fortesa Orana humb luftën, e cila ia mundësonte medaljen e bronzë evropiane

Fortesa Orana ka garuar në luftën për medalje të bronzë në kampionatin evropian të karatesë, që u mbajt në Guadalajara të Spanjës.

30 mars - Karateistja jonë u mposhtë me rezultat 2:1, nga finlandezja, Titta Keinanen, duke humbur mundësinë e artë që kombëtarja e karatesë të kthehet nga Spanja me medalje.

Orana kishte fituar të enjten tri luftëra (dy në repesazh), kurse kishte humbur njëren luftë, shkaku i diskualifikimit në sekondat e fundit.

Kombëtarja e karatesë mori pjesë në evropian me 10 garues.

Afër medaljes ishte edhe Elhami Shabani (-75 kg), i cili shënoi dy fitore, ndërsa në repesazh, humbi me vendim të gjyqtarëve, pasi rezultati ishte 0:0. Dy fitore kishte shënuar edhe Alvin Karaqi në kategorinë -84 kg, ndërsa garuesit tjerë u ndalën kryesisht në luftën e parë ose të dytën.

Të premten në ekipore, meshkujt mposhtën Malin e Zi, ndërsa u mundën nga Portugalia.

Ekspedita e karatesë u paraqit në evropian me simbole shtetërore, të cilat këtë herë u lejuan nga shteti i Spanjës, të cilët vazhdojnë të mos e njohin Pavarësinë e Kosovës.

Drejtësinë në evropian e ndau edhe gjyqtari ndër-kombëtar, Ardian Muhadri.



Flamuri i Kosovës valoi në Guadalajara të Spanjës, bashkë me flamujt e shteteve tjera

STANDING	NAME	ID	COUNTRY	CONTINENT	WORLD RANK	CATEGORY	TOTAL POINTS
27	ALVIN KARAQI	KOS2013	 KOSOVO (KOS)	EKF		M-84KG	1080
45	HEROLIND NISHEVCI	KOS2012	 KOSOVO (KOS)	EKF		M+84KG	735
293	DURIM HAZIRI	KOS2025	 KOSOVO (KOS)	EKF		M+84KG	37.5
STANDING	NAME	ID	COUNTRY	CONTINENT	WORLD RANK	CATEGORY	TOTAL POINTS
55	FORTESA ORANA	KOS2014	 KOSOVO (KOS)	EKF		F+68KG	667.5
STANDING	NAME	ID	COUNTRY	CONTINENT	WORLD RANK	CATEGORY	TOTAL POINTS
29	ELHAMI SHABANI	KOS2028	 KOSOVO (KOS)	EKF			667.5
STANDING	NAME	ID	COUNTRY	CONTINENT	WORLD RANK	CATEGORY	TOTAL POINTS
60	AJELINA RAMA	KOS2008	 KOSOVO (KOS)	EKF			277.5

Pozitat momentale të karateistëve tanë (31 mars 2019) në renditjen Olimpikë të WKF-së

Një karateist, i pari në renditjen botërore të WKF-së

Karateisti i ri, Melos Gashi, ka shënuar ngritje të madhe në renditjen më të re të Federatës Ndërkombëtare të Karatesë (WKF).

06 mars - Gashi ndodhet i pari në renditjen e kadeteve, kategoria plus 70 kilogramë.

Ky sukses i Melosit vjen pas bërjes nënkampion i Evropës, në kampionatin evropian të mbajtur muajin e kaluar në Aalborg të Danimarkës.

Melosi ka grumbulluar 1065 pikë në total, 30 më shumë se sa i dyti, Maros Janovcik (Slovakia).

“Shpresojmë që me këtë paraqitje të kohëve të fundit do të arrijë edhe titullin e më të miri të botës”, thuhet në njoftimin e Federatës së Karatesë së Kosovës.

Medaljen e bronzit në evropian e kishte fituar edhe Albulena Gërvalla, në grupmoshën U-21. Ajo në renditjen e re të WKF-së, ndodhet e 16-ta me 510 pikë të tubuara.



WKF RANKING					
CADET KUMITE MALE 70+ KG					
RANK	NAME	ID	COUNTRY	CONTINENT	TOTAL POINTS
1	MELOS GASHI	10000000000000000000	KOSOVO	EUROPE	1065.00
2	MAROS JANOVCIK	10000000000000000000	SLOVAKIA	EUROPE	1035.00
3	ALBULENA GERVALLA	10000000000000000000	KOSOVO	EUROPE	510.00
4	LESTER DOLY	10000000000000000000	UNITED STATES OF AMERICA	AMERICA	300.00

Karaqi shënoi dy fitore, Orana një, në Premier Ligën Dubai 2019

18 shkurt - Alvin Karaqi ka shënuar dy fitore për në kategorinë deri në 84 kilogramë, për t'u ndalur në luftën e tretë në Premier Ligën e karatesë Dubai 2019.

Karateisti ynë mposhti me rezultat bindës Pablo Zapatan e Spanjës dhe francezin Jessie Da Costa, ndërsa humbi nga Aykhan Mamayev i Azerbajxhanit (5:4).

Karaqi fitoi pikë Olimpikë për Tokio 2020. Ai ishte më i suksesshmi nga pesë garuesit që përfaqësuan Kosovën, në garën që nisi të premten dhe u mbyll të dielën.

Një fitore bindëse e shënoi edhe Fortesa Orana në kategorinë +68 kilogramë, ndërsa humbi në luftën e dytë.

Herolind Nishevci (+84 kg), Orges Arifi (-61 kg) dhe Elhami Shabani (-75 kg) u ndalën në luftën e parë.

Iu urojmë më shumë fat dhe suksese garuesve tanë, të cilët po e ndjekin normën Olimpikë.

Kombëtarja e karatesë garoi në Karate 1 Serie A "Salzburg 2019", Gërvalla doli e nënta

4 mars - 14 karateistë të kombëtares tonë kanë garuar në garën Karate 1 Series A për senior, të mbajtur në Salzburg të Austrisë.

Suksesin më të madh e arriti Albulena Gërvalla, e cila javë më parë fitoi medaljen e bronzit në Kampionatin Evropian U-21. Gërvalla në Salzburg, zuri vendin e nëntë nga 104 garuese, në kategorinë deri në 55 kilogramë. Ajo shënoi tri fitore, një në garat e rregullta, ndërsa dy në repesazh.

Tri fitore realizoi edhe Alvin Karaqi, i cili mbetet në garë për të fituar normën Olimpikë Tokyo 2020. Ai në kategorinë -84 kg u ndalë në luftën e katërt.

Sukses të njëjtë shënoi edhe Valdrin Rashiti (-67 kg), që realizoi tri fitore.

Durim Haziri (+84 kg) shënoi dy fitore, ndërsa me nga një fitore e mbyllën garën Elona Kolgeci (-61 kg) dhe Donita Elshani (-68 kg). Garuesit tjerë pësuan humbje në luftën e parë.

Herolind Nishevci nuk mori pjesë në këtë garë.

Kosovës i mungoi fati, i nisi me barazim kualifikimet për EURO 2020

Rastet e panumërta dhe loja e shkëlqyeshme nuk iu mjaftuan djelmoshave tanë që ta nisin me fitore ëndrrën Euro 2020. Kombëtarja e Kosovës barazoi 1:1 me Bullgarinë, në ndeshjen e luajtur në stadiumin e stërmbushur, Fadil Vokrri.

25 mars - Dardanët mbizotëruan lojën, dhe në të dyja pjesët krijuan raste ideale për shënim, por fati dhe portieri bullgar Mihaylov, nuk lejuan që të mposhtën më shumë se një herë.

Edhe këtë herë, Arbër Zeneli ishte ai që shënoi për tanët një super gol. Pas rasteve të humbura të Milot Rashicës e Bersant Celinës, të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Valeriy Bozhikov, të shënuar në minutën 38.

Në pjesën e dytë, dominimi i madh i lojtarëve tanë u kurorëzua me golin e Zenelit. Paraprakisht, Vedat Muriqi kishte qëlluar shtyllën.

Ovacionet e shumta që vinin pandërprerë nga tribuna, bënë që lojtarët tanë të marrin zemër, por rastet e Vedat Muriqit, Milot Rashicës e Edon Zhegrovës nuk shkuan në vendin e duhur.

Takimi u mbyll me ndarje pikësh. Kosova ndeshjen e ardhshme e luan ndaj Malit të Zi në udhëtim.

Në grupin A kualifikues për kampionatin evropian, janë edhe Anglia, Republika Çeke dhe Mali i Zi. Me një pikë të fituar ndaj Bullgarisë, Kosova ndodhet e treta në grup.



Kosova barazon me Danimarkën, meritoi edhe fitoren

Kombëtarja e Kosovës në futboll ka barazuar 2:2 me Danimarkën, në miqësoren e zhvilluar para rreth 13 mijë shikuesve në stadiumin Fadil Vokrri.

Djelmoshat tanë merituan edhe fitoren, në bazë të angazhimit, rasteve dhe lojës së treguar.

Kombëtarja e 10-të në botë barazoi shifrat vetëm në minutat shtesë me Hojbjerg.

Kosova shënoi e para me Amir Rrahmanin, dhe me epërsinë 1:0 shkoi në pushim.

Në pjesën e dytë barazoi Erikssen nga penalltia. Rezultatit në 2:1 e ktheu Bersant Celina, para se të barazonte në shtesë Hojbjerg.

Group A

	P	W	D	L	Pts
 England	2	2	0	0	6
 Bulgaria	2	0	2	0	2
 Kosovo	1	0	1	0	1
 Montenegro	2	0	1	1	1
 Czech Republic	1	0	0	1	0

 Group details



UEFA ia merr organizimin Spanjës për shkak të Kosovës

Ndeshjet e rrethit elitë të grupit të 5-të për Kampionatin evropian U-17 "Irlanda 2019" në futboll, të parapara të zhvillohen në Spanjë, do të luhen në Zvicër.

23 shkurt - "Një vendim të tillë e ka marrë UEFA, në sajë të këmbëngulësisë së presidentit Agim Ademi që Kombëtarja jonë të paraqitet me të gjitha simbolet në këto ndeshje, gjë e cila ishte e papranueshme për autoritetet spanjolle", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Edhe pse gjatë Kongresit të UEFA-s, presidenti Ademi ka kërkuar nga homologu i tij spanjoll, Luis Rubiales, që të shfrytëzojë ndikimin e tij tek institucionet spanjolle që të mos pengojnë hyrjen e ekspeditës tonë në asnjë formë, kjo nuk pati sukses, thuhet tutje në njoftim.

Kësisoj, presidenti Ademi bëri presion tek UEFA për ta zgjidhur këtë çështje dhe si rrjedhojë institucioni i futbollit evropian vendosi për t'ia

marrë organizimin Federatës spanjolle. Duke pasur parasysh faktin se në grup me Kosovën janë edhe dy shtete tjera që nuk e kanë pranuar pavarësinë e vendit tonë, Greqia dhe Ukraina, atëherë UEFA vendosi që vend mikpritës i ndeshjeve të grupit 5-të të jetë Zvicra. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen prej 20 deri më 26 mars.

Me marrjen e organizimeve të tilla, Spanja është kërcënuar edhe nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, pas presioneve që kishte bërë Komiteti Olimpik i Kosovës, me rastin e diskriminimit të sportistëve të Kosovës gjatë garimit në territorin e Spanjës.



Kosova kalon grupin parakualifikues për kampionatin botëror

2 shkurt - Kombëtarja e Kosovës në futsall ka kaluar grupin parakualifikues për kampionatin botëror 2020. Djelmohat tanë kanë shënuar fitore vendimtare ndaj Andorrës, me rezultat 5:3. Golat

për kombëtaren tonë i shënuan: Ramadan Alaj (3), Oso Gjinovci dhe Dardan Topilla.

Fitore 5:1 "dardanët" kishin shënuar edhe dy ditë më parë ndaj Norvegjisë, ndërsa humbjen e vetme e pësuan nga Bjellorusia.

Kosova grumbulloi gjashtë pikë dhe zuri vendin e dytë, pas Bjellorusisë, e cila ishte organizatore e ndeshjeve të grupit B.



Shkëlqimi i Milot Rashicës me Werder Bremen në Gjermani



Muajt: Janar, shkurt, mars 2019
Ndeshje: 10
Gola: 8
Asist: 1

Koreografia e tifozeve të Kosovës, Dardanët, para ndeshjes Kosovë-Bullgari



KOSOVAPRESS

AGJENCI E LAJMEVE / NEWS AGENCY

KosovaPress ju ofron shërbimin e përditshëm të lajmeve (7 ditë në javë) nga Kosova, rajoni dhe bota, për sektorët e politikës, ekonomisë, etj, nga ora 06.00 deri me 24.00. Prioritet i redaksisë janë temat, intervistat, reportazhet nga politika, ekonomia, çështjet sociale, kulturore, e të tjera.

KosovaPress përveç lajmeve me tekst ju ofron edhe shërbimin e Video Lajmeve, Audio Lajmeve dhe Fotove.

KosovaPress ju ofron shërbimin e lajmeve në dy gjuhë, gjuhën shqipe dhe angleze.

SHËRBIMI I PËRGJITHSHËM:

- Video Lajme
- Lajme tekst
- Audio Lajme / Foto
- Lajmet në gjuhën angleze
- Video aktivitete Live



EMISIONET

Departamenti i Produksionit të KOSOVAPRESS-it prodhon edhe emisione të ndryshme për televizionet vendore dhe ato jashtë vendit.

1. Emisione Familjaro-Edukative me qasje informuese për publikun
2. Promocional për Bizneset
3. Informues dhe Argëtues me qëllim të përmirësimit dhe informimit të drejtë të publikut

- Prodhimin e Videospoteve, Storieve, Dokumentarë
- Reklamimi në web dhe Emisionin Foleja



WWW.KOSOVAPRESS.COM

Kosova e pafat ndaj Rumanisë, vazhdon ëndrrën EuroBasket 2021

Kombëtarja e Kosovës në basketboll ishte e pafat, duke pësuar humbje nga Rumania në sekondat e fundit.

24 shkurt - Djelmoshat tanë u mposhtën në ndeshjen e fundit të Grupit B të raundit të dytë parakualifikues për "Eurobasket 2021", me rezultat 75:79.

Ndeshja e zhvilluar në Prishtinë ishte e barabartë që nga fillimi. Periudha e parë u fitua nga "Dardanët" 21:14, por mysafirët u afruan në fund të pjesës së parë duke mbyllur çerekun e dytë me rezultat 17:25. Në periudhën e tretë, Kosova arriti të merrte kontrollin në ndeshje duke fituar 23:17. Dhjetëminutëshi i fundit ishte më i mirë për mysafirët që fituan 14:23. Në minutat e fundit, Kosova luajti pa yllin Dardan Berisha që u përjashtua nga loja.

Kosova mbetet e treta në këtë grup, pas Maqedonisë dhe Rumanisë. Grupin ajo e mbyll me dy humbje nga Maqedonia dhe dy nga Rumania.

Kosova në grup me Britaninë e Madhe dhe Luksemburgun

Pas përfundimit të raundit të dytë të fazës

parakualifikuese për Eurobasket 2021, skuadrat lidere të secilit grup kanë vazhduar tutje, pra e kanë siguruar vendin në kualifikime, derisa dy ekipet e fundit të grupeve tani janë sistemuar në grupe të tjera dhe kështu e kanë fituar edhe një shans për të siguruar një vend në kualifikimet për Eurobasketin që do të mbahet pas dy viteve.

Kosova si e treta në Grupin B tashmë është sistemuar në Grupin G së bashku me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe.

Raundi i tretë i parakualifikimeve për Eurobasket 2021 do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht.

Fituesi i grupit do ta sigurojë një vend për në kualifikime për Eurobasket 2021.

Orarin e Përfaqësueses së Kosovës mund ta gjeni më poshtë:

Grupi G:

3 Gusht 2019 Luksemburgu - Kosova

7 Gusht 2019 Kosova - Britania e Madhe

14 Gusht 2019 Kosova - Luksemburgu

17 Gusht 2019 Britania e Madhe - Kosova





Kosova garoi për herë të parë në botërorin e skitarisë



Kombëtarja e Kosovës në skitari mori pjesë për herë të parë në kampionatin botëror, të mbajtur në Are të Suedisë.

Kosova do të përfaqësohet me katër garues: Albin Tahiri, Fiona Rrusta, Adea Kollqaku dhe Arbi Pupovci.

Përfaqësuesi i vetëm i Kosovës në Lojërat Olimpike

Dimërore PyeongChang 2018, Albin Tahiri, garoi në pesë disiplinat e skijimit alpin: Sllallom, slalom të madh, super sllallom i madh, kombinim alpik dhe lëshim. Tahiri pati paraqitje të kënaqshme, por duke qenë larg medaljes.

Paraqitje deri diku të kënaqshme patën edhe garuesit tjerë në disiplinat sllallom dhe sllallom të madh.



Kombëtarja e Kosovës në tenis për grupmoshën U-14 mori pjesë në kampionatin evropian të shteteve në zhvillim, që u mbajt në Antalia të Turqisë.

2019/3/5 11:08

Njeriu i dytë i volejbollit evropian vizitoi Kosovën

Zv. Presidenti i Konfederatës Evropiane të Volejbollit (CEV), Özkan Mutlugil, vizitoi për herë të parë Kosovën.

17 shkurt - Ai zhvilloi një vizitë dy ditore në Prishtinë. Mutlugil mori pjesë edhe në ceremoninë e laureatëve të volejbollit kosovar, si dhe në ndeshjen mes Kombëtareve A të Kosovës dhe Shqipërisë.

Po ashtu, ai u prit edhe nga drejtuesit e Ministrisë

për Kulturë, Rini e Sport.

Gjatë vizitës së tij, Mutlugil ka shprehur mirënjohje për punën që po bën Federata e Volejbollit e Kosovës.

“Federata e Volejbollit e Kosovës është shumë energjike dhe entuziaste e arritjeve akoma më të mëdha dhe një pune të jashtëzakonshme” - ta Mutlugil.

Ardhja e njeriut të dytë të volejbollit evropian, tregon edhe njëherë mbështetjen e rezervë që CEV e ka për anëtarin e saj të 56-të, Kosovën.



Ardit Delijaj, i argjendtë në turneun ndërkombëtar të boksit “Bocskai Istvan”

Ardit Delijaj i ka takuar medalja e argjendtë në turneun e63-të memorial ndërkombëtar “Bostvan Istvan”, që u mbajt në Debrecen të Hungarisë.

09 shkurt -Delijaj u mposht në finale nga holandezi, Artjom Kasparian, pas dorëzimit të meçit nga trajneri Shefki Bogujevci, shkaku i dhimbjeve në shpinë të Delijajt, njofton Federata e Boksit e Kosovës.

Delijaj në kategorinë deri në 81

kilogramë shënoi dy fitore në dy ditët e fundit, për t'u kualifikuar në finalen e sotme.

Pjesëmarrës në turne ishte edhe boksieri tjetër, Shpëtim Bajoku, i cili u mposht në luftën e parë të kategorisë -64 kg.

Në turne morën pjesë 27 shtete të botës me 182 boksierë, ku në mesin e tyre kishte edhe kampion bote dhe medalistë Olimpikë.

Në turne dhe në finale, drejtësinë e ndau edhe gjyqtari ndërkombëtar, Latif Demolli.





Muhamet Ramadani, atleti me të ardhme të ndritur

Talenti i atletikës, Muhamet Ramadani, Shpresë Olimpikë 2019, ka fituar medaljen e bronzit në Kampionatin Ballkanik U-20 me dyer të mbyllura (Indoor), që u mbajt në Stamboll.

16-vjeçari fitoi të bronzit në hedhjen e gjylës 6 kilogramë. Rezultati i tij ishte, 17.35 metra.

Ramadani ishte pjesëmarrës edhe në Lojërat Olimpikë për të rinj, Buenos Aires 2018, ku zuri vendin 12 nga 15 garues.

Në Buenos Aires ai garoi në disiplinën: Hedhje e gjylës 5 kilogramë.

Atleti nga Mitrovica vlerësohet shpresë për të ardhmen. Ai pritet ta përfaqësojë Kosovën edhe në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, Baku 2019, që në korrik mbahet në kryeqytetin e Azerbajxhanit.



Musa Hajdari, i argjendtë në kampionatin ballkanik të sallës

18 shkurt - Atleti Musa Hajdari ka fituar medaljen e argjendtë në kampionatin ballkanik të sallës për senior, të mbajtur këtë fundjavë në Stamboll të Turqisë.

Hajdari fitoi medaljen në disiplinën 800 metra. Ai arriti në cak me kohë 1:49.31, vetëm 11 të qindtat larg normës evropiane.

Musa Hajdari është bursist Olimpik për Tokio 2020. KOK përgëzon suksesin e Hajdarit dhe komunitetit të atletikës në Kosovë.

Presidenti Hasani priti trajnerin me famë botërore, Genadijus Sokolovas, i cili ligjëroi në seminarin për trajnerë të notit

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka pritur trajnerin e notit me famë botërore, Genadijus Sokolovas.

04 mars - Sokolovas ligjëroi në seminarin e FINA-s (Federata Ndërkombëtare e Notit), për nivelin e dytë të kursit për trajnerë të notit, në të cilin krahas trajnerëve nga Kosova, morën pjesë edhe trajnerë nga Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Britania e Madhe, Brazili etj.

Ish notari i njohur ka qenë drejtor i shkencave sportive, ku ka pasur rastin të punojë me elitën e notit, duke përfshirë kampionin e shumëfishtë Olimpik, Michael Phelps.

Presidenti Hasani falënderoi mysafirin nga SHBA-të për edukimin që po e bënë për trajnerët në këtë kurs, duke shprehur mirënjohjen e thellë dhe përkrahjen e vazhdueshme të Komitetit Olimpik të Kosovës për Federatën e Notit të Kosovës. Gjatë bashkëbisedimit presidenti Hasani kërkoi që bashkëpunimi i Federatës së Notit në Kosovë me ligjëruesin Sokolovas, të thellohet edhe më shumë gjatë këtij viti dhe bashkarisht edhe

me Komitetin Olimpik të Kosovës t'i mundësohet Sokolovit të vijë sërish gjatë muajit tetor në vendin tonë për të vijuar edhe nivelin e tretë të trajnimit për trajnerë.

I pari i Lëvizjes Olimpike në Kosovë, Besim Hasani, e njoftoi Sokolovasin edhe me vendimin e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut për të përkrahur edukimin në kampe jashtë vendit të trajnerëve të sporteve të ndryshme në Kosovë, si dhe me organizimin e kurseve për trajnerë dhe administratorë sporti.

Genadijus Sokolovas u shpreh mirënjohës për pritjen e bërë, duke shprehur përshtypjet e para se Kosova është vend me shumë talentë nëpër botë.

Ai foli për rëndësinë që ka organizimi i kursit të nivelit të dytë, në të cilin po e bartë përvojën e tij tek trajnerët e shumë pjesëmarrës.

I pranishëm në takim ishte edhe sekretari i përgjithshëm i Federatës së Notit të Kosovës (FNK), Astrit Haliti.



KOK dërgon trajnerët e federatave në kampe jashtë vendit

Komiteti Olimpik i Kosovës do të nisë një fazë të re të përkrahjes së federatave sportive në Kosovë.

12 mars - Bordi Ekzekutiv i KOK-ut ka vendosur në mbledhjen e 31-të të dërgojë trajnerët e federatave në kampe apo shkollime që organizohen jashtë vendit.

Qëllimi i kësaj përkrahje është shkollimi i trajnerëve dhe marrja e përvojave të reja, të cilat do të mund t'i zbatonin tek sportistët e federatave të tyre.

Në mbledhjen e radhës të BE të KOK-ut do të vendosen edhe kriteret, të cilat duhet t'i plotësojnë federatat për dërgimin e trajnerëve.

Kjo është vetëm njëra nga format e mbështetjes së KOK-ut për

federatat, pas përkrahjes që bënë çdo muaj për Bursistët Olimpikë, Shpresat Olimpikë, përgatitjet e sportistëve para garave të rëndësishme ndërkombëtare, ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si: kurset për administratorë sporti, kurset për trajnerë, si dhe kursi i avancuar për menaxhimin sportiv (ASMC 1).



21 mars - Presidenti i KOK-ut Besim Hasani vizitoi Festivalin e Tenisit "Tennis Fest 2019", i cili për dy ditë u mbajt në sheshin Zahir Pajaziti në Prishtinë



Për shkak të bashkëpunimit të frytshëm dhe duke qenë krahë i djathtë i aktiviteteve të shumta të Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Haxhijaj, ndanë mirënjohje të veçantë për Kosova Pressin, të cilët më 4 janar festuan 20 vjetorin e themelimit.

Ngritja e hendbollit

Kombëtarja e Kosovës në hendboll, konkurrenca e femrave, nuk do të luajnë më në parakualifikime.

14 mars - Ngritja e kombëtares së Kosovës në hendboll (femrat) është konfirmuar edhe nga Federata Evropiane e Hendbollit (EHF). EHF-ja ka përcaktuar vazot për shortin e kualifikimeve për "Euro 2020" dhe në vazo është edhe Kosova. Pra Kosova për herë të parë paraqitet direkt në kualifikimet e rregullta e jo në parakualifikime. Kjo ndodhë për shkak të rezultateve pozitive të kombëtares tonë në vitet e fundit. Për "Euro 2016", Kosova nuk ia ka dalur të kalojë me sukses parakualifikimet, ku ishte në grup me Finlandën e Izraelin.

Për "Euro 2018", Kosova kaloi me sukses parakualifikimet duke fituar ndaj Izraelit e Gjeorgjisë. Kështu siguroi kualifikimet e rregullta dhe ndeshjet me kombëtare elitare si Hungaria, Holanda e Bjellorusia. Për "Euro 2020" Kosova nuk bënë pjesë në parakualifikime fare. Në parakualifikime janë Izraeli, Finlanda, Greqia e Luksemburgu. Këto kombëtare do të luajnë mes vete prej 31 majit deri më 2 qershor dhe vetëm fituesi i grupit kalon aty ku tashmë është Kosova. Shorti për kualifikimet e rregullta për "Euro 2020" do të hidhet më 4 prill në Kopenhagë. Në kualifikime do të paraqiten kampioni i vitit 2018, Franca, nënkampioni, Rusia dhe Holanda që ishte e treta. 28 ekipe kombëtare do të paraqiten në kualifikime, ndërsa do të formohen shtatë grupe me nga katër kombëtare. Dy të parët e secilit grup kualifikohen për në

kampionatin evropian që mbahet në dhjetor të vitit 2020 në Norvegji e Danimarkë.

Për shortin e kualifikimeve, Kosova do të jetë në vazon e katërt së bashku me Zvicrën, Islandën, Portugalinë, Lituaninë, Ishujt Faroe dhe fituesin e parakualifikimeve. (Shkrim i marrë nga FHK)

Kosova e 28-ta në Evropës

Kombëtarja e Kosovës në hendboll (femrat) renditet në vendin e 28-të në ranglistën evropiane. Është kjo një pozitë e mirë e Kosovës që kështu lë pas vetes plot 21 kombëtare tjera evropiane.

Kombëtarja jonë i ka 44 pikë dhe ndanë vendin e 28-të me Ishujt Faroe. Kosova ka lënë prapa në ranglistë Izraelin, Finlandën, Bullgarinë, Greqinë, Azerbajxhanin, Gjeorgjinë dhe shumë ekipe kombëtare tjera.



Shigjetarët garuan në Kampionatin Evropian “Samsun 2019”

28 shkurt - Ekipi i shigjetarëve të Kosovës ka mbyllur të mërkurën garimin në kampionatin evropian, që po mbahet në Samsun të Turqisë.

Atdhe Luzhnica dhe Hazir Asllani, garuan në kategorinë e seniorëve, ndërsa Drenis Mala e Edi Dvorani në atë të juniorëve. Të gjithë garuan në disiplinën hark Olimpik.

Atdhe Luzhnica doli i 27-ti me gjithësej 542 rrathë. Në pozitën e 28-të, nga po aq garues, u radhit Hazir Asllani me gjithësej 541 rrathë. Në rrethin e parë eliminues, Luzhnica pësoi humbje 6:0 nga kampioni Olimpik, Victor Ruban nga Ukraina. Me rezultat të njëjtë u mund edhe Hazir Asllani nga Anton Prilepov të Bjellorusisë. Të dy garuesit, Luzhnica e Asllani fituan pikë Olimpikë Tokyo 2020.

Në kategorinë e juniorëve, Edi Dvorni pati një paraqitje të suksesshme, duke u renditur në pozitën e 28-të me gjithësej 549 rrathë, kurse Drenis Mala u radhit në pozitën e 31-të nga po aq garues, me 530 rrathë. Dvorani kishte paraqitjen më të mirë në evropian dhe në eliminime.



18 mars - Një e artë dhe një e bronzë është bilanci i medaljeve të fituara të Kosovës në Lojërat Olimpike Speciale Botërore, që po mbahen në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, prej 14 deri më 21 mars. Medaljen e artë e ka fituar Sheqi Vllasaliu në atletikë, disiplinën 200 metra, ndërsa në të njëjtën garë, të bronzën e fitoi Ibish Zogaj.



FBOUK organizoi turneun e gjashtë me radhë të Kampionatit Ballkanik “Kosova 2019”

26 shkurt - Në organizim të Federatës së Boulingut të Kosovës (FBOUK), në fundjavë është mbajtur edicioni i gjashtë me radhë i turneut të kampionatit ballkanik të boulingut “Kosova 2019”, që për katër ditë u zhvillua në qendrën Albi në Prishtinë.

Pjesëmarrës ishin nëntë shtete: Kosova, Shqipëria, Bullgaria, Maqedonia, Sllovenia, Greqia, Turqia, Mali i Zi dhe Rumania. Në hapjen solemne i pranishëm ishte edhe presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Evropiane të Boulingut, Marios Nicolaides, si dhe drejtori i sportit në Komunën e Prishtinës, Fitim Rexha.



Festivali Sportiv për Parafillorët

Datë: 19 prill 2019

Vendi: Stadiumi Fadil Vokrri

Pjesëmarrës: 2700 parafillorë

të Komunës së Prishtinës

52 institucione parafillore

Ora: 09:15

Moto: "Premtoj fort, do të
merrem me sport"



Dita Olimpike 2019

Data: 27 maj

Vendi: Në të gjitha komunat e Kosovës

Pjesëmarrës: Fëmijët e lindur në vitin e Pavarësisë (2008)



Pamje nga Dita Olimpike 2015, në të cilën kishte marrë pjesë edhe presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach



Kredi në **10 min**
Vetëm me letërnjoftim

QATU PËR QATU!

www.iutecredit.org

038 40 60 80